

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7757 E martë 8 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga ANDON ANDONI



Sipas traditës së kishës ortodokse autoqefale, enisur në diasporën e shqiptarëve të Amerikës një shekull më parë, më 16 mars, në Boston ku u mbajt kongresi ...  
Vijon në faqen 18

Po mbledhim ca fonde, po kujt t'ia dërgojmë!?

Opinion i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



Ndërrimi i më shumë se gjysmës së anëtarëve të kabinetit qeveritar pak ditë përpara gjelit të Vitit të Ri ndoshta u bë për t'u kthyer shpresën njerëzve tek qeveria ...  
Vijon në faqen 19

Kuaj të ndërruar, shpresë e mërguar



Intervista/ Presidenti, i ftuar në "News 24"

## Ilir Meta: Arsyet pse nuk e firmos shkarkimin e Bushatit. Ministrat në verifikim

"Rama kur vjen në zyrën time është shumë mirëkuptues dhe bashkëpunues"

ADI KRASTA

Presidenti Ilir Meta, i ftuar mbrëmë në emisionin "A Show", në "News 24" foli për ndryshimet në qeveri dhe pse po vonon dekretin për ministrat e rinj që nuk janë deputetë. Gjithashtu, kreu i shtetit foli edhe për ...  
Në faqen 3

ASTRITI MERR FLORJAN HABILAJN: E VERTETE KJO QE DEGJOJME? MOS E ÇAJ B...

## PERGJIMET E 'HABILAJVE', KUSH U PERFSHI NE TRAFIK

9 të pandehurit në gjykatë. Prokuroria: Akuzohen për trafik droge dhe krijim të grupit të strukturuar kriminal. Dy letërporosi mbajnë peng Tahirin



(Në foto) Moisi Habilaj. Faksimile e pergjimeve për grupin "Habilaj"



Në faqet 8-9

ÇFARË NDODHI

28-vjetori i 'RD', mungojnë Patozi e Blushi. Basha ngre dollari për gazetarët

Në faqen 2

FLASIN PEPA E GJERGJI

Minatorët: Mjaft më, të miratohet statusi, ose Rama të largohet! Ngrihuni në protesta

Në faqen 12

AKUZAT

Eksplodiv shtyllës së tensionit të lartë, gjysma e vendit rrezik terri

Në faqen 7

DETAJET

E vërteta e lidhjes së Flor Mumajesit me Kejsi Tolën, çfarë i bën bashkë dy artistët

Në faqen 14

KRYEMINISTRI: PAKTI PER TO U MIRATUA



Studentët, bojkot mësimit e protestë, Albina Ruko: Ramën s'e shpëtoi ironia

Në faqet 4-5

FSDKSH: Barnat me rimbursim, kush mund t'i marrë falas ose me 50% zbritje

## Sigurimi shëndetësor, përfitimet e pensionistëve

Zbardhen kategoritë që përfshihen në skemë, afatet e procedura

NGA VOLTIZA DURO

Të gjithë ata qytetarë që paguajnë kontributet për sigurimet shëndetësore, kanë të drejtë të përfitojnë rimbursimin e barnave si dhe mund të marrin disa shërbime mjekësore falas. "Gazeta Shqiptare" publikon sot përfitimet



që mund të kenë pensionistët, invalidët e plotë apo dhe kategori të tjera individësh falë sigurimit shëndetësor. "Masa e kontributit të sigurimit të detyruar shëndetësor është 3,4% e bazës për llogaritjen e kontributeve. Për të punësuarit, kontributet paguhen ...  
Në faqet 10-11

## PËRVJETORI MESAZHET

Në 28-vjetorin e themelimit të 'RD'-së, i ftuar Mustafaj, mungojnë Patozi dhe Blushi

# Basha ngre doli për gazetarët: PD do ju mbështesë gjithmonë

"Përballja me sfidat, edhe këtë vit të rëndësishëm"

Valentina Madani

Në 28-vjetorin e theme-  
limit të "Rilindjes  
Demokratike", kreu i  
PD-së, Lulzim Basha, ngri  
një doli për të gjithë  
gazetarët. Para pjesëmar-  
rësve të shumtë, duke vlerë-  
suar profesionin fisnik, kreu  
i demokratëve garanoi se PD  
do të jetë në krah të çdo gaze-  
tari për çdo betejë të tyre.  
"Uroj të gjithë gazetarët, duke  
e parë gotën gjysmë plot dhe  
të gjithë bashkë ta mbushim  
këtë gotë, jo me të zezat që ky  
regjim ka derdhur ndaj medi-  
ave, por me të mirat dhe qën-  
dresën e tyre. Garantoj në emër  
të PD-së, se PD do të jetë në  
krah të tyre. Për ne nuk  
ka vijë ndarëse midis dallëndy-  
shes së parë të fjalës  
së lirë, 'RD' dhe çdo gazetar  
që vazhdon të ushtrrojë këtë  
mision fisnik dhe sfidues.  
Duke ju garantuar për mbështet-  
jeten tonë totale, në të gjithë  
betejat personale, institucio-  
nale kombëtare dhe ndërkom-  
bëtare më lejoni të ngre një  
gotë për shëndetin tuaj dhe  
të familjeve tuaja, në nderim  
të profesionit tuaj fisnik.  
Qoftë ky një shembull për të  
gjithë gazetarët e vendit! Një  
vit të mbarë për Shqipërinë  
dhe shqiptarët dhe një vit të  
mbarë për lirinë e medias!",  
deklaroi z.Basha. Kreu i Partis-  
ë Demokratike uroi theme-  
luesit dhe bashkëpunëtorët  
ndër vite të kësaj gazete. Në  
priten e organizuar në nder  
të 28-vjetorit të krijimit të  
gazetës "Rilindja Demokra-  
tike", kryeredaktori Bledi  
Kasmi renditi ngjarjet më të  
rëndësishme të vitit 2018. Kas-  
mi u shpreh se protesta e stu-  
dentëve ishte një nga ngjar-  
jet më të rëndësishme, e cila  
ngalli shprehjen për një dje-  
tor të dytë. "Protesta e stu-  
dentëve ngalli energji dhe  
shpresë që mund të kemi një  
djetor të dytë si ai në vitin  
1992, që rrezoi regjimin komu-  
nist. Një protestë e rëndë-  
sishme ishte edhe ajo e  
Kukësit. Mirënjohje për të  
gjithë ata gazetarë kurajozë  
që zbuluan skandale që u  
kanë kushtuar dhe do u kusht-  
tonin shqiptarëve shumë sh-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në 28-vjetorin e themelimit të "Rilindjes Demokratike"

### URIMI

"Uroj të gjithë gazetarët, duke e parë gotën gjysmë plot dhe të gjithë bashkë ta mbushim këtë gotë jo me të zezat që ky regjim ka derdhur ndaj mediave, por me të mirat dhe qëndresën e tyre. Garantoj në emër të PD-së, se PD do të jetë në krah të tyre", tha z.Basha.

## "Kryeministri jeton në luks të shfrenuar"

# PD: Shtëpia 400 milionë lekë, Rama përdor gruan si 'mburojë'

Partia Demokratike sulmoi dje kryeministrin Edi Rama në lidhje me pasurinë që ai ka deklaruar. Zëdhënësjë e PD-së, Ina Zhupa akuzoi se Rama jeton mes luksit në një shtëpi prej gati 400 milionë lekësh, ndaj nuk mendon për studentët ose 290 mijë fëmijë që ushqehen vetëm 1 herë në ditë. Sipas demokratëve, Edi Rama ka bërë zgjedhjen më burraçake, duke vendosur që për të gjitha akuzat mbi pasurinë e tij marramendëse të përdorë gruan si mburojë. Zhupa tha se është koha që Edi Rama të mos fshehet më pas gruas, por t'i dalë për zot dhe të japë llogari për luksin e paturpshëm. Zhupa deklaroi: "Për Edi Ramën ka rëndësi vetëm ruajtja e standardit të jetës mes luksit. Luks në shtëpinë e tij në Surrrel, luks në zyrën kryeministore me salla masazhi dhe dhoma puroje, luks me studion e punëve



### AKUZA

"Edi Rama e nisi karrierën me 10 milionë lekë dhe sot vetëm vlera e shtëpisë superluksoze në Surrrel është deklaruar 400 milionë lekë. Ai thotë se tokën ku është ndërtuar shtëpia ia ka blerë gruaja. Dasmën e bën me kursimet e gruas, shtëpinë superluksoze e paska ndërtuar me kursimet e gruas. Madje edhe në bankën me pronarë fantazmë në parajsë fiskale e ka vënë në emër të gruas", tha z.Zhupa.

private me oxhak 18 mijë euro. Sipas një dokumenti të brendshëm të OSBE-së, Rama për 11 vjet kryetar i Bashkisë së Tiranës zotëronte në 2015 një pasuri të fshehur 200 milionë euro. Imagjinoi sa është shtuar pasuria e fshehur e Ramës, pasi ka dhënë çdo gjë me koncesion tek një grup klientësh të oborrit të Surrrelit". Zhupa akuzoi më tej: "Rama e nisi karrierën me 10 milionë lekë dhe sot vetëm vlera e shtëpisë superluksoze në Surrrel është deklaruar 400 milionë lekë. Ai thotë se tokën ku është ndërtuar sh-

tëpia ia ka blerë gruaja. Dasmën e bën me kursimet e gruas, shtëpinë superluksoze e paska ndërtuar me kursimet e gruas. Madje edhe në bankën me pronarë fantazmë në parajsë fiskale e ka vënë në emër të gruas. Edi Rama ka bërë zgjedhjen më burraçake duke vendosur që për të gjitha akuzat mbi pasurinë e tij marramendëse të përdorë gruan si mburojë. Kryeministri ka detyrimin të shpjegojë pse luksi real dhe pasuria e tij nuk përputhen me deklaratën e pasurisë".

së Re. Janë raste vërtet të rënda kërcënimesh, por tregojnë se gazetarët janë ngritur dhe po përballen me forcë me regjimin. 2018-ta konsiderohet viti i parë që kemi të paktën 14



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

### SHKURTE

## Shehi paralajmëron Bashën: S'hyjmë në zgjedhje me 'Kodin' e vjetër

Demokratët kanë zëruar çdo mundësi rikthimi në Kuvend. Pas rrëzimit nga mazhoranca të nismës kushtetuese për vetëtim në politikë, aleatët e opozitës gjykojnë se vendi i tyre duhet të jetë në institucione. "Unë gjykoj që do jemi sepse hyr e dil, kjo nuk do kishte ndonjë vlerë të madhe", tha kryetari i LZHK-së, Dashamir Shehi, për "Klan". Reforma zgjedhore për aleatët e Partisë Demokratike është arsyeja se përse opozita do duhet të jetë në Kuvend, në një kohë kur kanë mbetur më pak se 6 muaj nga zgjedhjet lokale. Shehi përsëriti kërkesën për ndryshimin e sistemit elektorral dhe i kujton Bashës se do të jetë kundër arritjes së një marrëveshjeje me Edi Ramën, nëse do tentohet të shkohet në zgjedhje me Kodin e vjetër Elektorral. "Me 'Kodin' e vjetër ne nuk shkojmë. Ne, pjesa tjetër e opozitës kemi kundër kësaj marrëveshjeje që mund të bëjë PD me PS-në. Në qoftë se nuk ka ndryshim sistemi brenda zgjedhjeve është e kotë", shprehet Shehi. Sa për aksionin opozitar, kreu i Lëvizjes për Zhvillim Kombëtar, Dashamir Shehi zbulon se pjesë e skenarit janë edhe protestat, ndonjëse për të opozita ende nuk ka një datë. "Ne si opozitë e kemi bërë detyrën tonë, do vazhdojmë ta bëjmë tani në rrugë", tha Shehi.

## Kandidate për Tiranën? Tabaku flet për sondazhet dhe emrat e PD

Pas Dashamir Shehit, deputetja e PD, Jorida Tabaku është një nga emrat e përmendur së fundmi si një kandidat e mundshme e opozitës për Bashkinë e Tiranës. Ajo ishte e ftuar në "A2", ku ndër të tjera foli edhe për kandidatin e mundshëm të opozitës për bashkinë e kryeqytetit. Tabaku nuk e mohoi një kandidim të mundshëm, por u shpreh se kushdo të jetë, ajo do ta mbështesë, ashtu siç bëri edhe 4 vite më parë me Halim Kosovën. "Nuk e di çfarë thonë sondazhet. Ka disa emra që janë përmendur nga PD-ja, të them me siguri që kushdo që do të zgjidhet, unë do jem në krah të tij", deklaroi deputetja e PD-së, Jorida Tabaku.

deklarata të institucioneve për mbrojtjen e gazetarëve", u shpreh z.Kasmi. Në festën e mbremshme të RD-së ishin të ftuar edhe ish-gazetarit i saj Ben Blushi dhe ish- kryere-

daktori Astrit Patozi, por asnjëri prej tyre nuk iu bashkua përvjetorit të Rilindjes Demokratike. Mes të ftuarve ishte edhe ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj.

REDAKSIA: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafilë VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjëse e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvira Ljaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0682074415-email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotransportit, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik" Shpk

“Rama kur vjen në zyrën time është shumë mirëkuptues dhe bashkëpunues”

# Mosdekretimi i 5 ministrave, Presidenti Meta: Po i verifikoj

## "Arsyet pse nuk firmos shkarkimin e Bushatit"

Adi Krasta

**P**residenti Ilir Meta, i ftuar mbrëmë në emisionin "A Show", në "News 24" foli për ndryshimet në qeveri dhe pse po vonon dekretin për ministrat e rinj që nuk janë deputetë. Gjithashtu, kreu i shtetit foli edhe për protestat e studentëve dhe banorëve të Unazës së Madhe, teksa kërkoi zgjidhje institucionale për ta.

**Z. President, shkarkimi i ministrave nga kryeministri shkaktoi diskutim në publik dhe publiku po pret përgjigjen tuaj në raport me mosdekretimin e z. Bushati. Çfarë do të ndodhë në raport me dekretimin e z. Cakaj? Përse nuk e dekretuat z. Bushatit?**

Dua t'ju siguroj që edhe në këtë rast, Presidenti i Republikës do t'i përmblusë të gjitha detyrimet e tij kushtetuese dhe ligjore për t'ju përgjigjur vullnetit të kryeministrit, gjithmonë në interes të respektimit të Kushtetutës dhe të respektimit të ministrit, si institucion kushtetues. Në këtë drejtim, besoj se u përgjigja menjëherë në lidhje me ministrat, pra me dekretimin e lirimit të tyre, përveç ministrit të Jashtëm, dhe me emërimin e të gjithë deputetëve apo figurave të njohura politike në post ministri, të cilët për arsye të pozicioneve të tyre publike, i kanë kaluar disa filtra në të kaluarën. Lidhur me pjesën tjetër, ata që janë emra të rinj, kanë nevojë t'u nënshtrohen verifikimeve përkatëse. Përsa i takon ministrat të Jashtëm do të bëj një sqarim: Mendoj se ky është një pozicion tepër i rëndësishëm dhe delikat. Çdo pozicion ministri është i tillë, por arsytet rreth përfshirjes së Shqipërisë në disa iniciativa mjaft të rëndësishme si në Trojkën e OSBE-së, në...

**Institucioni duhet të ketë një lojë vazhdimësie...**

... vazhdimësie, për arsye të integritimit evropian dhe për çdo gjë tjetër. Dhe mendoj se Shqipëria nuk duhet të jetë për asnjë sekondë pa ministër të Jashtëm.

A i ka kërkuar Institucioni i Presidentit, ose a duhet t'i kërkojë një informacion zyrtar me firmë e me vulë të firmosur nga Presidenti i Republikës, ose nga zyra e tij ligjore, kryeministrit të Kosovës në raport me ministrin e sugjeruar Cakaj?

Nuk do të dëshiroja të hyja në komente, por ne do të bëjmë të gjitha kërkimet apo verifikimet për...

**A ka reaguar kryeministri Rama ndaj mosdekretimit të shkarkimit të Bushatit dhe pritjes për të bërë një veting ndaj ministrat Cakaj?**

Nuk ka pasur ndonjë ar-



Presidenti Ilir Meta, mbrëmë në emisionin "A Show", në "News 24"

## Ministrat



PRESIDENTI

"Lidhur me pjesën tjetër, ata që janë emra të rinj, kanë nevojë t'u nënshtrohen verifikimeve përkatëse. Përsa i takon ministrat të Jashtëm, do të bëj një sqarim: mendoj se ky është një pozicion tepër i rëndësishëm dhe delikat", tha Presidenti Ilir Meta.

sye të reagojë. Ne kemi bërë një bisedë në mbrëmjen e 4 janarit, kur ai ka kërkuar takim për të paraqitur dekretet. Ka dhënë edhe disa shpjegime të tij, përveç materialeve shoqëruese për propozimet.

**Ku e bëtë këtë takim?**  
Këtu, ku jemi bashkë, në zyrën time.

**A është ndryshe zoti Rama këtu në takim me ju nga performanca që ai ka zakonisht në publik, në televizion?**

Jo, unë nuk kam asnjë ankesë për sjelljen.

**Jo, jo ankesa. A është ndryshe?**

Sigurisht që këtu është shumë mirëkuptues dhe bashkëpunues.

**A ka momente servilizmi?**

Nuk besoj dhe nuk ka asnjë arsye.

**A mund të thotë: "Ilir, shiko, ne mund ta themi këtë, por midis nesh? Kjo është kështu, dhe le ta mbyllim këtu e të themi që ta bëjmë apo të mos e bëjmë?"**  
Mendoj se takimet janë tepër korrekte.

**Si e gjykuat ju nga pikëpamja institucionale, shkarkimin e rreth 70% të ministrave të qeverisë?**

Ajo që më shqetëson në këtë fillimjanari është pikërisht ajo që shpreha një ditë pas vendimit të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian në qershor se, "Shqipëria do të ketë një mundësi qershore e ardhshme", pra atë që po vjen, për çeljen e negociatave, nëse do të realizojë disa suksese në disa reforma kyçe që tashmë dihen. Madje, edhe një ditë pas unë kam thënë që nuk është koha për t'u gëzuar, sepse një vit kalon. Siç kalon një ditë, do të kalojë edhe një vit. Shqetësimi im është që në këto gjatëmbledhjet muaj nuk kemi atë klimë përgjegjshmërie midis aktorëve kryesorë, në radhë të parë do të thosha të qeverisë së të opozitës, dhe të funksionimit të Kuvendit për të dhënë ato garanci që kanë nevojë të gjithë qytetarët shqiptarë, ose partnerët ndërkombëtarë se Shqipëria do të mund të çelë negociatat në qershorin që po vjen. Kjo është më e rëndësishmja. Tani

është e ministrave: kjo është një zgjidhje e kryeministrit për të bërë...

**Çështje e ekzekutivit? Është një përgjegjësi.**

...për të bërë vlerësimet e tij, për të propozuar, për të dhënë shpjegimet e tij. Për mua, sikurse e kam shprehur që ditën që jam njohur me këto ndryshime, duhet të ndryshojnë disa politika, sepse e kam thënë dhe e them prapë: Mundi i ndryshojë çdo ditë ministrin e Bujqësisë. Në rast se nuk do të ndryshojmë politikën për bujqësinë, mbështetjen për bujqësinë, kjo është një gjë që nuk do t'u shërbente as fermerëve, as ekonomisë sonë kombëtare dhe askujt tjetër. Këtë gjë mund ta themi edhe për fusha të tjera dhe nuk na duhet për të mësuar kaq shumë nga Danimarka apo nga Holanda, që janë jashtëzakonisht të zhvilluara në këtë drejtim, por na duhet të mësojmë pak më shumë nga Maqedonia për çështjen e mbështetjes së bujqësisë. Apo goftë edhe nga Kosova në këtë drejtim dhe të jemi të sigurt se ndryshimi do të jetë shumë i shpejtë, sepse edhe potencialet e Shqipërisë për këtë zhvillim në fushën e bujqësisë e të agro-turizmit janë të jashtëzakonshme.

**Dua t'ju flas pak për protestat. Ju i kuptuat? I mbështetët protestat e studentëve të universiteteve në Tiranë? A e kuptuat atë që ata donin të thoshin?**  
E njoh prej kohësh shqetësimin e studentëve dhe të shumë pedagogëve dhe drejtuesve të përgjigjshëm...

**Jeni pro? Jeni kundër protestave...?**

Shqipëria nuk ka vuajtur nga protesta, por nga mungesa e protestave. Shqipëria ka vuajtur nga largimi nga vendi i shumë qytetarëve dhe jo nga protestat për të përmirësuar qeverisjen. Protestat janë një lajm i mirë, për atë kohë sa ato janë paqësore dhe zgjojnë ndërgjegjen e qytetarëve për të pasur kërkesa më të larta në radhë të parë ndaj vetes së tyre. Dhe kuptohet ndaj qeverisë, ndaj opozitës, ndaj institucioneve, sepse demokracia do të jetë atë e fortë sa ne e bëjmë atë.

**Ju jeni një president jo i relaksuar, por një president i shqetësuar në raport me tri vatra të rëndësishme protestash në këtë vend, që janë protesta e studentëve kundër ligjit të Arsimit të Lartë, protesta e familjeve që do të lëvizin nga "Astiri" dhe protesta e artistëve dhe dashamirësve të këtij vendi kundër prishjes së Teatrit Kombëtar. Keni kontaktuar, përveç veprimave që keni bërë nga pikëpamja institucionale si president? Dhe natyrisht, përveç mendimeve që keni për protestat, ju zoti Meta, a keni kontaktuar, a jeni takuar me ta? A jeni në brendësi të shpirtit të asaj që po ndodh me këta njerëz që kanë dalë për të protestuar?**

Përsa i takon çështjes së Teatrit Kombëtar, si Institucion i Presidentit të Republikës jemi shprehur dy herë: përmes kthimit të ligjit dhe të argumenteve të kthimit, që besoj se kanë qënë mjaft solide. Përsa i takon çështjes së "Astirit" apo të banorëve të Unazës së Re, ne kemi bërë kërkimet tona ndaj institucioneve për të verifikuar se si qëndron e vërteta e këtij projekti. Duket qartë që i gjithë ky projekt ka probleme serioze të transparencës dhe të standardeve ligjore dhe etike që duhen ndjekur në një rast të tillë. Sigurisht që për interesin publik mund të demotohet apo mund të priset prona, pavarësisht nga statusi ligjor i saj, i cillido qytetari, por kjo duhet të bëjë në mënyrë të qartë dhe strikte ligjore dhe transparente, në mënyrë që askush të mos ndihet i diskriminuar, i papërfilluar apo me keq, i shtypur dhe njëkohësisht të mos ketë as hapësirë për opozitën apo për segmente të saj për të instrumentalluar gjithë këtë mungesë transparente apo mbi problemet ligjore.



## Qeveria e re, Berisha: Studentët, jo gjenerata e kokave të turkut

**I**sh-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje se pasardhësi i tij, Edi Rama, duke hedhur gjithë qeverinë, mendoj se studentët do të qetësoheshin. Sipas Berishës, nuk është gjenerata e kokave të turkut. "Është një i sëmurrë psikik që nuk përmbahet dot dhe e tregon veten në mënyra të ndryshme. Ai nuk di ku të shkojë. I tha studentit në Vlorë se i kam paratë e emigracionit. Tani që sara jet po bëhen gjithë e më të mëdha, nuk di ku të futet. Këta janë të përfshirë në transaksione të tmerrshme. Ky solli në qeveri hiçin negativ. Ia dha financat një personi që falimentoi fondin, vetëm sepse është shoqëri e Madam Bashës. Mori Belindën që kalonte Riforमतon për transportin e drogës. Sa i përket ministrat të Jashtëm, ky njeri vihet sepse është mbështetës i projektit të ndarjes së Kosovës. Unë nuk kam asnjë paragjykim prej krahinës, por ky zotëri përfaqëson më shumë se këdo tjetër Beogradin, Baton Haxhiun", deklaroi z. Berisha për "Ora News".

# PROTESTA E STUDENTËVE REAGIMET

Kryeministri bëri të ditur se kërkesat e studentëve kanë hyrë në rrugën e realizimit

## Mbyllja e fakulteteve, Rama: Fytyra e pengmarrësve të protestës

### Qeveria ka miratuar Paktin për Universitetin

Studentët rinisën dje protestën e tyre para Kryeministrit kundër kushteve në të cilat ndodhet arsimi i lartë në Shqipëri. Por, para se të mblidheshin në bulevard, disa prej tyre mbyllën dyert e disa fakulteteve, duke mos lejuar studentët dhe stafin e pedagogjik që të hynte në auditorë. Ky veprim ka sjellë reagimin e ashpër të kryeministrit Edi Rama, i cili i ka konsideruar këto akte si të dhunshme dhe produkt i elementëve që sipas tij kanë marrë peng protestën e studentëve. Njëpër një koment në rrjetet sociale, Rama tha se mbyllja me dhunë e dyerve të disa fakulteteve është fytyra kuptimplotë e pengmarrësve të protestës. "Mbyllja me dhunë e dyerve të disa fakulteteve është fytyra kuptimplotë e pengmarrësve të një proteste shembullore", - shkroi Rama. Më tej, ai shtoi se kërkesat e studentëve kanë hyrë në rrugën e realizimit dhe kjo falë edhe atij që ai e konsideroi si një dialog i brendshëm për çdo fushë studimi dhe fakultet.

Kryesore të studentëve, vendimi i miratuar parashikon se studentët nga familje në ndihmë ekonomike, si edhe të verbrit dhe studentët paraplegjikë e tetraplegjikë, përfitojnë financimin 100% të tarifës së regjistrimit. Jo vetëm kaq, por studentët nga familje me ndihmë ekonomike, të verbër, paraplegjikë e tetraplegjikë përfitojnë gjithashtu bursë

10.000 lekë në muaj. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj vendimmarrje materializohet edhe premtimi që studentët me notë mesatare mbi 9, në çdo program studimi, përfitojnë financimin 100% të tarifës së regjistrimit nga tarifat e plotë që paguanin përpara këtij vendimi, si dhe bursë 10.000 lekë në muaj. Ndërsa të gjithë studentët e tjerë përfitojnë financimin

50% të tarifës së regjistrimit. Por, vendimi i qeverisë përcakton se studentët e humbasin këtë mundësi, nëse nuk mbajnë gjatë studimit një mesatare mbi 6 në vitet pasardhëse. Sa i përket nivelit të dytë të studimeve, qeveria merr përsipër që për studentët me notë mesatare mbi 9 në hyrje, studentët nga familje në ndihmë ekonomike, si edhe të verbrit dhe studentët paraplegjikë e tetraplegjikë, jetimë, fëmijët e policëve të vrarë, të përfitojnë financimin deri në 50% të tarifës së regjistrimit. Ndërsa sa i përket kërkesës për përmirësimin e kushteve të jetesës në konvikte janë parashikuar rreth 300 milionë lekë shtesë për kryerjen e investimeve në infrastrukturën e konvikteve për vitin 2019. Ndërsa nëpërmjet një financimi total prej 16.8 milionë euro dhënë nga qeveria gjermane do të mundësohet rehabilitimi i një numri maksimal prej 13 godinash të rezidencave studentore universitare në Tiranë.



Kryeministri Edi Rama

## Protesta, Duma: Pedagogët nuk janë paguar për dhjetorin

Deputetja e PD-së, Grida Duma deklaroi se për shkak të protestës që kanë zhvilluar studentët dhe e rinisën tashmë pas pushimeve të fundvitit, pagat e pedagogëve për muajin dhjetor nuk janë ndarë, megjithatë, ata nuk flasin. "Unë jam pedagoge në Universitetin e Tiranës, të Shkencat Sociale. Tani e jashtë, por kam qenë e brendshme prej 15 vitesh. E dini ju që nuk kanë kaluar pagat e pedagogëve në të gjithë Shkencat Sociale? Plas këtu për muajin dhjetor, nuk kanë kaluar pagat. Arsyja është se, edhe pagat e tyre varen 35 për qind nga tarifat e studentëve, universiteti duhet të mbahet nga tarifat e studentëve. Problemet e studentëve për të paguar tarifat kanë sjellë edhe mungesën e pagave për pedagogët. Asnjëri prej tyre nuk reagon, unë habitesha



se përse nuk reagonin ata, por me sa duket qëndrimi i pedagogëve sot është në solidaritet me një çështje më të rëndësishme, që janë vetë studentët. Ata po qëndrojnë në vijën e dytë, për të thënë se pagat e tyre janë më pak të rëndësishme sesa kauza e madhe e studentëve. Sistemi është i tillë, në të cilin vetë reforma në Arsimin e Lartë ka shkaktuar katastrofë cilësie

e menaxhimi, e çfarë ka prodhuar në fund fare? A mund të imagjinojmë ne, se një universitet publik do të ketë mundësi të menaxhojë me efikasitet paratë, njësoj si entitet privat? Kjo është e pamundur. Të gjithë historinë e menaxhimit midis privatit dhe publikut ne e dimë shumë mirë se ku shkon dhe ku anon", deklaroi Duma në "Top Talk".



Protesta e djeshme e studentëve

## Rikandimi i Veliajt, Balla: Ka justifikuar besimin e dhënë

Taulant Balla, kreu i grupit parlamentar të PS-së, ka vlerësuar pozitivisht punën e Erjon Veliajt në krye të Bashkisë së Tiranës. I pyetur në emisionin "5 Pyetjet", nëse PS do të rikandidojë Veliajn për një mandat të dytë, Balla nuk iu përgjigj drejtpërdrejt pyetjes, por tha se Veliaj e ka justifikuar besimin e PS-së, kryeministrit Rama dhe votuesve. "Dua t'iu them shumë qartë që ne kemi disa kritere vlerësimi dhe i kemi përcaktuar e bërë publike sa herë që kryesia e PS mblidhet për të dalë më pas me vendimin për kandidatët për kryetarët e 61 bashkive, bëhet një vlerësim. Për ata që janë në detyrë bëhet një vlerësim i performancës, ndërkohë që edhe për ata që vijnë nga pozicione të tjera bëhet një vlerësim i performancës dhe i vlerësimit që ka publiku, votuesi i zonës përkatëse për të. Veliaj meriton gjithë respektin jo vetëm të socialistëve, por edhe qytetarëve për një super-sukses në mandatin e parë. Veliaj e ka justifikuar jo vetëm besimin e PS, besimin e Ramës, por edhe të atyre që e kanë votuar", tha Balla.



## Dita e 65, banorët e "Astirit": Shtëpitë i mbrojmë me çdo çmim

Banorët e "Astirit" kanë dalë dje në ditën e 65 të protestës duke kundërshtuar projektin e Unazës së Re, pa u dëmshpërlyer më parë sipas vlerave të tregut. Në mbështetje të tyre ishin edhe deputetë të opozitës. Klevis Balliu tha se shtëpitë e këtyre banorëve do të mbrohen me çdo "çmim" dhe PD është gati ta paguajë këtë "çmim". "Nuk do ketë as Edmond Bego, as Taulant Balla, as Erion Veliaj dhe as Edi Rama që do mund të vijnë dhe të shkatërrojnë shtëpitë e këtyre qytetarëve, sepse do të mbrohen me çdo çmim. Çmimet janë për t'u paguar dhe PD është gati të paguajë ato çmime bashkë me ju, deri fund, deri ditën që ju të fitoni, që një ditë të drejtojmë të gjithë bashkë", - tha Balliu. Deputeti demokrat tha se fuqia e sovranit është më e madhe se e qeverisë. "Qeveria duhet të kuptojë që presioni ndaj këtyre qytetarëve me pseudopolicë nuk funksionon. Nëse këtu këta mendojnë se mund të përdorin forcën e disa banditëve, e kanë shumë gabim. Nuk ka asnjë organizatë, asnjë qeveri të ketë më shumë forcë sesa sovranin dhe qytetari. Sovrani është këtu dhe kur të jep ultimatum ose dorëzohu, ose rrëzohu", - tha Balliu.

"Të përgjysmohen tarifat në të gjitha nivelet e studimit, veçanërisht në master"

# Studentët nuk tërhiqen, bojkot mësimit e protestë para Kryeministrit

Albina Ruko: Edi Ramën nuk do e shpëtojë dot cinizmi dhe ironia

Voltiza Duro

Studentët e universiteteve publike kanë bojkotuar mësimin ditën e djeshme dhe kanë protestuar para Kryeministrit për plotësimin e kërkesave dhe rrezimin e ligjit të arsimit të lartë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Albina Ruko, studente, njëkohësisht aktiviste e lëvizjes "Për Universitetin" tregon se protesta do të vazhdojë dhe format e saj do të vendosen nga vetë studentët. Ajo thekson se kryeministri Edi Rama nuk ka guxim të merret me seriozitetin e kërkesave, duke shpresuar që do i kalojë pa u lagur përmes deklaratave të tilla.

**Sot (dje) studentët kanë bojkotuar mësimin për të rinisur sërish protestën e tyre deri në plotësimin e 9 kërkesave. A do të ketë përshkallëzim të protestës?**

Nuk e di se çfarë mund të kuptojmë me përshkallëzim, por jemi të sigurt që përpjekja do vazhdojë. Ne mendojmë se përshkallëzim ka qenë gatishmëria për t'i qëndruar besnik kauzës së nisur, përshkallëzim ka qenë rezistenca për të mos e takuar Ramën, përshkallëzim ka qenë edhe rritje graduale e numrit të protestuesve në dy javët e para të protestës. Në vazhdim mund të ketë forma më kreative të protestës, mund të ketë zhvendosje apo ndërrim i metodës, por e gjitha kjo varet nga vendimet që mund të marrin studentët e fakulteteve specifike, pasi të jenë takuar në oborret e tyre përkatëse. Mbetet për t'u barë gatishmëria dhe vullneti i masës së studentëve.

**Pse kërkon fuqimisht rrezimin e ligjit të arsimit të lartë?**

Para se ta elaborojmë përgjigjen, vlen të theksohet që lëvizja "Për Universitetin" ka qenë konsistente në kundërshtimin e këtij ligji që në ngjizjen e tij, sepse ne që në fillim e kemi kuptuar që një ligj i tillë do sjellë jo vetëm degradim të cilësisë së arsimit, por edhe probleme të jashtëzakonshme nga ana ekonomike, të përballueshme për studentët. Si pasojë e këtij ligji, ne sot edhe pas premtimit gjysmak të kryeministrit, nuk kemi garanci për uljen e tarifave, kjo sepse ulja e tarifave bie në kundërshtim me vetë logjikën e tij që parasheh rritje graduale tarifash për studentët deri në arrijten e një vetëfinancimi nga ana e universiteteve. Rregullimi i burokracisë së universitetit në formën e një korporate, ku ai që jep më shumë para për universitetin emëron pjesën më të madhe të anëtarëve të bordit, tregon hapur për logjikën neoliberalë të ligjit. Ulja e peshës së votës studentore, që erdhi si rezultat i miratimit të ligjit, po ashtu bie në kundërshtim të plotë me kërkesën tonë për



Studentja Albina Ruko duke folur për "Gazeta Shqiptare"

## DEKLARATA

Kur s'ke ç'i bën gomarit, i bie samarit. Ai nuk ka guxim të merret më me seriozitetin e kërkesave, duke shpresuar që do i kalojë pa u lagur përmes deklaratave të tilla. Atë e ka zënë një hall i madh dhe nuk do e shpëtojë as cinizmi, as ironia e aq më pak batutat që i vetëcilëson si tepër të denja për konkurrencë.

## Protesta, dy studentë shoqërohen në komisariat

Ditën e djeshme dy studentë protestues janë shoqëruar për rreth një orë nga policia në Komisaratin Nr. 1. Përkatësisht bëhet fjalë për studentët, Vilson Kulemani dhe Gëzim Almeta dhe mendohet se dy të shoqëruarit kanë gozhduar dhe kyçur dyert e Universitetit Politeknik dhe të Juridikut. Ditën e djeshme studentët fillimisht janë mbledhur nga ora 08-09:30 para fakulteteve për t'u bashkuar më pas në orën 10:00 para Kryeministrit dhe kanë gozhduar dhe kyçur dyert e disa fakulteteve.



## LIGJI

Sot edhe pas premtimit gjysmak të kryeministrit, nuk kemi garanci për uljen e tarifave, kjo sepse ulja e tarifave bie në kundërshtim me vetë logjikën e tij që parasheh rritje graduale tarifash për studentët deri në arrijten e një vetëfinancimi nga ana e universiteteve. Rregullimi i burokracisë së universitetit në formën e një korporate, ku ai që jep më shumë para për universitetin emëron pjesën më të madhe të anëtarëve të bordit, tregon hapur për logjikën neoliberalë të ligjit.

rritje të peshës së votës studentore. Financimi i universiteteve private përmes fondit të ekselencës, përmes fondit të kërkimit shkencor dhe doktoraturave janë vetëm disa nga aspektet më të ububushme të ligjit. Jo vetëm kaq janë arsytet e këmbënguljes sonë për anulimin e tij, por një analizë

më e detajuar do donte shumë më shumë rreshta dhe kohë.

**Sa u plotësuar kërkesat tuaja, pas vendimeve të përfshira në Paktin për Universitetet?**

Kërkesa për ulje tarifash në të gjitha nivelet e arsimit të lartë është e qartë që nuk është pranuar nga kryemi-

nistri. Ai ka ulur tarifat vetëm për nivelin bachelor dhe jo atë master, që padyshim është shumëfish më i shtrenjtë e problematik se ai i pari. Zgjedhja e anëtarit të shtatë të bordit të universitetit nga ana e studentëve është vetëm një hile për të mashtruar në pamje të parë për kthimin e autonomisë së universitetit në duart e universitarëve, sepse të gjithë e dimë se qeveria dhe partitë politike i kanë mjaftueshëm në dorë strukturat e këshillave studentorë sa për ta pasur nën kontroll zgjedhjen e këtij anëtar. Qeveria nuk ka garantuar rritje të buxhetit e madje, as nuk ka treguar se me çfarë parash do paguhet pjesa e mbetur e tarifave. Mungesa e qeverisë për të rrëzuar ligjin e arsimit të lartë është mungesë e garancisë për realizimin e cilësdo nga kërkesat.

**Kryeministri Rama e ka cilësuar mbylljen e dyerve të fakulteteve si "fytirën e pengmarrësve të një proteste model". Si e komentoni deklaratën e Ramës?**

Kur s'ke ç'i bën gomarit, i bie samarit. Ai nuk ka guxim të merret më me seriozitetin e kërkesave, duke shpresuar që do i kalojë pa u lagur përmes deklaratave të tilla. Atë e ka zënë një hall i madh dhe nuk do e shpëtojë as cinizmi, as ironia e aq më pak batutat që i vetëcilëson si tepër të denja për konkurrencë.

**A ka pasur fakultete apo studentë që e kanë vijuar mësimin normalisht ditën e sotme (djeshme)?**

Nuk ka pasur asnjë fakultet që ka vijuar mësimin normalisht. Raste

specifike, ku pedaogë të caktuar kanë shantazhuar studentët me mungesa, apo student të caktuar janë futur me dëshirë në mësime ka pasur edhe në kulmin e proteste, por deri tani mbeten raste të izoluar.

**Mund t'i listoni edhe njëherë kërkesat e studentëve të universiteteve publike?**

Ne mendojmë se pikat më të rëndësishme për të cilat duhet të luftohet në këto kushte janë këto: Përgjysmimi i tarifave në të gjitha nivelet e studimit (sidomos në master); rritjen në 50% të peshës së votës studentore, dyfishimin e buxhetit të shtetit për universitetet publike, ndalimin e financimit publik të universiteteve private. Asnjë kërkesë nuk mund të realizohet pa rrezimin e ligjit të arsimit të lartë. Pa harruar të gjitha pikat e shtruar nga studentët deri tani.

**A ka pasur tentativa nga aktorë të ndryshëm të forumeve apo partive politike për të politizuar protestën?**

Po, ka pasur. Eksponentët të forumeve partiake kanë qenë problematikë në protestë që në ditën e dytë të saj. Metodat e tyre tashmë të skaduar, sado që janë demaskuar publikisht dhe janë diskredituar nga studentët, kanë arritur që të shkaktojnë mjaftueshëm probleme sa të vënë në pikëpyetje shpeshherë për sytë e studentëve çiltërsinë e protestës. Kjo madje është një nga faktorët që ka ndikuar në uljen e numrit të protestuesve në njërin apo në vendin tjetër të protestës.



## Universitetet e rretheve i bashkohen Tiranës

Në një kohë kur studentët e universiteteve publike në Tiranë kanë rinisur dje protestat, të njëjtin lëvizje kanë bërë edhe kolegët e tyre në rrethe. Kështu, pas bojkotit disajavor, një grup studentësh të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" janë organizuar për vazhdimin e protestës. Ndërkohë një tjetër grup i vogël u është rikthyer auditorëve. Ndërkohë, në protestë janë ngritur edhe studentët të universitetit "Fan Noli" në Korçë. Studentët e Fakultetit të Ekonomisë u grumbulluan tek korpusi i universitar. Pavarësisht temperaturave të ulëta, studentët shprehën të vendosur për vijimin e kauzës së tyre deri në plotësimin e kërkesave. "Nuk do t'u kthehemi auditorëve, kërkesat janë plotësuar pjesërisht. Ka përpjekje për të përcarë protestën dhe për të blerë studentët, por shumica e studenteve janë në mbështetje të kërkesave të artikuluara nga të gjitha universitetet", pohuan studentët.

## Ish-ministri ka vlerësuar vetëm emërimin e Braçes

## Mustafaj: Gent Cakaj s'ka profil, Rama të zgjidhte Veton Surroit

## MUSTAFAJ

"Rama nuk ka dhënë asnjë argument politik për largimin e Bushatit nga posti i ministrit dhe se emri i zgjedhur për të pasur atë nuk është një figurë dhe një statuturë me profil të qartë. Nëse do të ishte një zgjedhje e duhur në krye të Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë, emri i duhur do ishte ai i Veton Surroit".

Surroit. "Kryeministri duhet të japë argumente politike. Për shkarkimin e Bushatit, Rama nuk dha argumente politike. Mata ka shprehur rezervë serioze për dekretimin e Gent Caka-

mosmarrëveshje për Kosovën. Nëse do të ishte një zgjedhje të vlerësojmë se sa dinjtoz ka qenë ministri i Jashtëm me Greqinë. Nuk kam asnjë skenar dhe nuk e njoh Cakajn. Unë besoj se duhet të ishte një njeri me shumë ndikim dhe me njohuri. Rrugën për negociatat nuk është vetëm çështje teknike, por varet prej shumë agjencive. Nëse do të merrte një personalitet nga Kosova, mund të merrte një njeri të statuturës së Veton Surroit", tha Must-



Ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj

tafaj. Gjithashtu, ai ka kritikuar ministrin e ri të propozuar nga Rama në krye të Ministrisë së Jashtme edhe për faktin se gjëja e parë që nxitoi të bëte sapo u emërua, ishte sipas tij shpërndarja e

kartvizitave si ministrë. "Zgjedhja e ministres së Arsimit është në këtë hulli. Adekuete është vetëm zgjedhja e Erion Braçes, të nxitoi të bëte sapo u emërua, ishte sipas tij shpërndarja e

Mazhoranca është detyruar të thërrasë mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit

# Dekretet mbërrijnë në Kuvend, javën tjetër mbledhet seanca

Kushtetuta i jep legjislativit 10 ditë kohë

Mazhoranca e majtë do jetë e detyruar që brenda javës së ardhshme ta thërrasë Kuvendin e Shqipërisë në seancë të jashtëzakonshme për të votuar dekretet e kreut të shtetit për shkarkime dhe emërimi ministrash. Kjo, pasi Kush-tetuta në nenin 98 të saj përcakton se dekreti shqyrtohet brenda 10 ditëve nga Kuvendi. Nisur nga fakti se presidenti Meta shpalli një pjesë të dekreteve të tij ditën e shtunë më 5 janar, atëherë Kuvendi në bazë të këtij detyrimi kushtetues duhet të mbledhet brenda datës 15 janar. Por burime nga shumica e majtë kanë bërë me dije se ai s'afat llogaritet data e hyrjes në protokoll dhe Kuvend ka 10 ditë kohë nga protokollimi i tyre. Atëherë nëse do të merret kjo datë parë bazë, seanca e ardhshme do të mbahet brenda datës 17 Janar. Burime nga mazhoranca kanë bërë me dije dhe se dekretet kanë mbërritur dhe janë protokolluar vetëm gjatë ditës së hënë në Kuvend dhe i janë përcjellë kryetarit të këtij institucioni, Gramoz Ruçi, për të nisur procedurën ligjore parlamentare për shqyrtimin e tyre. Të njëjtat burime kanë saktësuar se ende nuk është vendosur se kur do jetë seanca parlamentare, ndërsa janë në pritje të vendimit që do të marrë këtu i shtetit për pjesën tjetër të emrave të ministrave që ka në tavolinë për dekretim. Në këtë mënyrë, shumica e majtë po pret që të skadojë afati që kreu i shtetit ka në dispozicion për dekretimin e pjesës tjetër të ministrave dhe më pas të thërrasë një seancë të jashtëzakonshme ku t'i votojë një herësh. Sipas të njëjtit nen të Kushtetutës, presidenti ka vetëm 7 ditë kohë për të dekretuar emrat e propozuar për shkarkim dhe ata për emërim dhe nisur nga fakti se ata i kanë shkruar të premtën e shkruar; atëherë ai duhet të vendosë për fatin e tyre deri të premtën e ardhshme. Më konkretisht, Ilir Meta ka edhe 4 ditë kohë për të vendosur nëse do t'i dekretojë emrat e ministrave të rinj dhe lirin e ministrit të Jashtë-



Gjatë një seance parlamentare

tëm, Dimtir Bushati. Të shtunë ai firmosi dekretet për lirin nga detyra të 7 ministrave sipas propozimeve të bërë nga Rama, ndërsa refuzoi të firmosë dekretin për lirin e Dimtir Bushatit. Mësohet se mosdekretimi i lirin të Bushatit nga detyra e kryediplomatit lidhet me faktin se vendi ndodhet vetëm 6

muaj para marrjes së një përgjigjeje pozitive për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian dhe se pozicioni i ministrit të Jashtëm duhet të jetë shumë i konsoliduar. Natyrisht, ky mund të jetë edhe një paralajmërim se Meta mund të refuzojë të dekretojë emrin e Genti Cakës, i propozuar nga Rama për të

zëvendësuar Bushatin. Deri më tani në media dhe në publik janë hedhur hije dyshimi se Caka nuk përmbush kritere ligjore, pasi ndërjetet të tjerave nuk zotëron certifikatën e sigurisë. Për këtë qëllim, Meta si për Cakën ashtu edhe për 4 emrat e tjerë të rinj, të propozuar nga Rama dhe që nuk vijnë nga radhët e politikës, ka kërkuar informacione shtesë nga institucionet ligjzbatuese. Më konkretisht për Besa Shahinin, si ministre e Arsimit dhe Sportit; Anila Denaj, ministre e Financave dhe e Ekonomisë; Elva Margariti, ministre e Kulturës; Belinda Ballukun, ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Genti Cakën si ministër i Jashtëm, Presidenti Meta ka kërkuar më shumë informacion, pasi ata nuk janë as deputetë.



## Votimi në Kuvend, si u përçka mazhoranca për kreun e KLSH-së

Në një nga seancat e fundit të sesionit të shkuar, Kuvendi i Shqipërisë rrëzoi dekretin e kreut të shtetit, Ilir Meta me anë të të cilit ai kishte propozuar Vitore Tushën në krye të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Pa praninë e deputetëve të opozitës, mazhoranca e majtë votoi kundër këtij dekreti, me argumentin se kandidatura ishte e mirë, por ajo ishte njëkohsisht pjesë e Gjykatës Kushtetuese dhe Këshillit të Lartë të Emërimeve. Dhe me argumentin për të mos dëmtoj këto dy institucione, shumica qeverisëse hodhi poshtë me votë këtë propozim të presidentit. Por jo të gjithë deputetët socialistë e respektuan vendimin e grupit, pasi dekreti mori 71 vota kundër, 1 pro dhe 3 vota abstenim. Sipas tabulatit të votimit që ka bërë publik Kuvendi, pro ka votuar deputeti Pjerin Ndreu, ndërsa kanë abstenuar 3 deputetë gra të grupit parlamentar të PS-së. Bëhet fjalë për Vasillika Hysin, Eglantina Gjermiin dhe Almira Xhambullën, të cilat ashtu si Ndreu kanë votuar individualisht pa marrë parasysh vendimin e grupit.

## Media greke: Një kosovar 30-vjeçar do rinovojë qeverinë "Rama"

Propozimi i Gent Cakajt si ministër i ri i Jashtëm i Shqipërisë për të zëvendësuar Dimtir Bushatin ka bërë jehonë edhe në shtetin fqinj, Greqinë. Përveç ish-ministrit Kozias dhe ministrit të Jashtëm plotësues grek, Georgios Katrugalos, edhe mediat greke i kanë kushtuar një pasqyrim të gjerë propozimit të kryeministrit Rama për të zëvendësuar Dimtir Bushatin me Gent Cakajn. Kështu, gazeta "Protothema" i ka kushtuar kësaj çështje-



je një artikull me titull "Vetëm 30 vjeç dhe kosovar, ministri i ri i Jashtëm i Shqipërisë". "Kryeministri Edi Rama vendosi të zëvendësojë Dimtir Bushatin me një kos-

var 30-vjeçar. Siç tha vetë kryeministri shqiptar gjatë prezantimit, Gent Cakaj do të jetë figura që do sjellë rinovimin në qeveri. Këshilltari i deritanishëm i Ramës në postin e ri ka ngjallur mjaft debate, pasi janë të shumtë zërat që vënë në dyshim aftësitë e tij për këtë post. Megjithatë, vetë kryeministri shqiptar, i thirrur të mbrojë përzgjedhjen e tij deklaroi se 'ministri i ri ka lexuar shumë më tepër libra sesa fjalë thoni ju kundër tij', - thuhet në këtë artikull.

Medar KAJOLLI Permbasës Gjyqësor Privat me seli në Rr. "Uran Pano" Pll.1/3, Kati-2, Tiranë, nxjerr në shtipë në ankan pasuritë e paluajtshme si me posthë;

Publikuar Nr. 1/574, Vol.-32, fq.-207, T.K.-8210, Illoji Njësi me Sip.-32 mt, Tiranë, më vlerë 3591/072 (Tëri mision e përcaktimit e nentitshijet e një mijë e shtatëdhjetë e dy) Lekë, në promesi të debitorit Z.Besnik Binaku.

Shijja e pasuritë të paluajtshme do të bëhet (Zhvillohet) në datë 11.01.2019, ditën e Premte, ora 16.00 në Zyren e Permbasës Gjyqësor Privat Z. Medar KAJOLLI, në Adresën Rruga "Uran Pano", Pll.-1/3, Kati-2, Tiranë.

Per informacione mund të kontaktoni Nr.Tel.+355 66 20 333 63, ose në Adr.-email: medar.kajolli@gmail.com

Ngjarja në Fushë-Krujë, Balla akuza Berishës: Si s'hoqe dorë o burrë

FUSHE-KRUJË

Rikthehen sulmet me eksploziv në Fushë-Krujë. Një shtyllë e linjës së tensionit të lartë që lidh Tiranën me Podgoricën, nga e cila kalon 50% e konsumit energjetik në të gjithë vendin, ka rënë pre e një shpërthimi tritol. Burime nga policia dje bënë me dije se sasia e konsiderueshme e lëndës plasëse është vendosur në shtyllën 400 kv të linjës së tensionit të lartë, e cila ndodhet në afërsi të gurores së fabrikës së vjetër të çimentos në Fushë-Krujë. Si pasojë e shpërthimit është dëmtuar një nga këmbët e kësaj shtylle, që është ndër më të lartat që ka vendi ynë. Ndërkohë, burime zyrtare nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) bënë me dije se po punohet për të shmangur stakimin e kësaj linje, që do të kishte pasojë shumë të rënda në furnizimin me energji elektrike në vend. "Aktualisht, njësitë speciale të OST janë duke ndërhyrë për të shmangur stakimin e kësaj linje, që do kishte pasojë shumë të rënda në furnizimin me energji elektrike në vend. Flukset e energjisë që injektohen në këtë linjë sot janë 50% e konsumit në gjithë vendin. OST dënon këtë akt të rëndë kriminal dhe ka kryer veprimet procedurale në organet e drejtësisë, me synim gjetjen e autorëve dhe vënien e tyre para përgjegjësisë", - thuhet në njoftim. Ndërkaq, Operatori i Sistemit të Transmetimit ka kryer edhe veprimet procedurale në organet e drejtësisë, me synim

# Eksploziv shtyllës së tensionit të lartë, gjysma e vendit rrezikon të mbetet pa energji

## Shpërthimi ka dëmtuar një nga këmbët e shtyllës, ende asnjë person i dyshuar për aktin terrorist



Shtylla e dëmtuar nga tritol

gjetjen e autorëve dhe vënien e tyre para përgjegjësisë. Momentalisht nga policia nuk ka ende asnjë person të dyshuar. Sipas Kodit Penal, sulmet me shpërthim tritol cilësohen akte terroriste. Aktualisht në të gjithë vendin situata e furnizimit me energji është normale, por nëse shtylla nuk do të arrijë të riparohet,

importet e energjisë që vijnë përmes kësaj linje do të bëheshin të pamundura për t'u marrë, çka do të sillte edhe kufizime të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët.

**REAGIMI I TAULANT BALLËS**

Pas shpërthimit me eksploziv të shtyllës së linjës së tensionit të lartë Tiranë-



Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla

Podgoricë në Fushë-Krujë ka reaguar kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, i cili ka hedhur akuza në drejtim të ish-kryeministrit Sali Berisha. "Kishe ca kohë e kishe harruar këtë 'sport' po aha, plakesh e rrjedh po nuk heq dorë ti joo...", - thotë Balla ndër të tjera përmes një statusi në "Facebook".

**STATUSI I PLOTË I BALLËS**

O Sali! Po si nuk hoqe dorë as nga shtyllat e tensionit mor burrë i dheut! Kishe ca kohë e kishe harruar këtë 'sport' po aha, plakesh e rrjedh po nuk heq dorë ti joo... Bam aty e bum atje të shkoi kjo jeta demokratike, se në atë jetën komuniste e kishe urdhëro këtej e si urdhëron andej!

**Refuzon të lindë fëmijë, çifti në Sheqeras: Jetojmë në ferr**

**KORÇË** - Në Sheqeras, fs-hati ku temperaturat në dimër arrijnë deri në minus 18 gradë celsius, jeton edhe familja Kollcinaku. 10 vite me parë një pakujdesi me bombolën e gazit ua bëri banesën shkrumb e hi. Vitet e fundit ata kanë gjetur strehë në një pikë furnizimi me karburant. Pa energji elektrike dhe pa ujë prej 5 vitesh, me nënë dhe vëllanë të sëmurë mendërisht, jeta e Spartakut është kthyer në ferr. "Që kur kemi hyrë këtu as drita, as ujë nuk kemi. Tani më janë lidhur këmbët dhe duart kujdesem për të sëmurët, jam në këtë pikë sot", tha ai. Të mbledhur rreth një sobe që më shumë nxjerr tym sesa ngroh me dru të dhuruar nga kisha engjëllore shqiptare ditët të paspashës se do shohin një ditë të bardhë... Djali i madh familjes ka mbetur i paralizuar qysh 8 vjeç. E ëma dhe ai vuajnë nga problemet mendore. KEMP-i i tyre është gjithçka që ka kjo familje. "Nuk e përballojmë dot jetesën me KEMP, nuk na del as për ilaçe, tani në dimër këtu nuk ka punë. Gjatë beharit edhe fitoj 4 mijë lekë të vjetra këtu afër", u shpreh Spartaku. Ai dhe nusja e tij rryfen vuarjet e përditshme të varfërisë, por edhe indiferencën e fqinjëve për t'u ofruar pak ujë të pijshëm. "Katastrofë po e quaj, edhe kur shkoj tek fqinjët, nuk më japin gjithmonë ujë, këtë avaz ke ti më thonë, por unë nuk kam ku të shkoj", tha nusja e shtëpisë, Marinela. Çifti nuk ka fëmijë. Bashkëshortja e Spartakut refuzon të sjellë në këtë botë një foshnjë. Ajo e sheh të padrejtë që një fëmijë të përjetojë këtë mjerim. "Që kur jam martuar këtu kam ardhur, në këtë pikë karburanti. Ka qenë shumë, shumë e vështirë gjithmonë. Kjo është arsyeja që s'kam krijuar familje, nuk mund të lind një foshnjë në këtë gjendje që jemi. Me dy të sëmurë dhe me një foshnjë nuk di ç'të bësh më përpara", u shpreh Marinela.

**U godit me sende të forta nga 2 persona të maskuar Dhunohet dhe grabitet kambisti 100 m larg komisariatit të policisë, në kërkim autorët**

**TIRANË** - Paraditen e djeshme, persona ende të paidentifikuar kanë dhunuar dhe grabitur një kambist në Tiranë. Mësohet se ngjarja ndodhi në rrugën "Mine Peza". Sipas bluve, preh e sulmit ka rënë shtetasi Bujar Shkurti, i cili është goditur me sende të forta. Po të njëjtat burime pohuan se autorë të krimit kanë qenë dy persona, të cilët ishin duke lëvizur me motor dhe në kokë mbanin skafandra. Agresorët e kanë goditur kambistin dhe i kanë marrë me forcë çantën e dorës. Policia ka nisur hetimet për ngjarjen në fjalë, ndërsa po punohet për kapjen e autorëve të grabitjes. Aktualisht nuk dihet shuma e lekëve që i është grabitur kambistit. Fillimisht ka qenë ish-kryeministri Sali Berisha që ka denoncuar ngjarjen. Berisha teksa ka publikuar edhe foto të një personi që shfaqet i gjakosur në fytyrë, pohon se ai është përgjakur nga maskat.



Qytetari dixhital i shkruan Berishës se ngjarja në fjalë ndodhi rreth orës 10:30 në rrugën "Mine Peza". Ndërkohë ai shton se pavarësisht faktit që policia ishte njoftuar, ajo mbërriti në vendngjarje 15 minuta me vonesë, ndërsa ambulanca jo. **DENONCIMI TË BERISHA** Maskat përgjakin kambistin në mes të Tiranës! Lexoni denoncimin e qytetarit dixhital dhe shikoni fotot e tij. sb Përsëritet doktori, grabitet kambisti në mes të ditës,

në zemër të kryeqytetit, në rrugën e mbushur plot me biznese dhe në sy të qindra qytetarëve që po kalonin në atë moment dhe panë ngjarjen. Ngjarja ndodhi sot në orën 10:30 dhe vetëm 100 metra larg komisariatit nr: 3, në rrugën "Mine Peza". Policia vjen 15 minuta me vonesë dhe ambulanca edhe pse ishte njoftuar, nuk erdhi fare! Mjerne ku jemi katandisur: Ishin 2 veta me motor, me maska, që e kanë goditur. I dëmtuari është pronari 'exchange' të kryqëzimit i rrugës "Mine Peza".

**Aksidenti me 2 të vdekur e 5 të plagosur në Levan: I mbijetuari: Si na mori para makina**

**FIJER** - Një ditë pas aksidentit tragjik të ndodhur në autostradën Levan-Tepelenë, ku humbën jetën dy persona dhe u plagosën 5 të tjerë, mësohet se 4 nga të dëmtuarit janë jashtë rrezikut për jetën, ndërsa njëri është në gjendje të rëndë. Konkretisht, në gjendje të rëndë është i plagosuri Jorgo Meraj, që është transferuar në Tiranë. Ndërsa të plagosurit Haxhi Lamaj dhe Agron Cecollari ndodhen në reaminacion jashtë rrezikut për jetën. Sakaq, Sokol Dhima ka dalë nga spitali pasi ka paraqitur parametra jetësorë normale pas ndihmës së marrë, ndërsa aktualisht në pavion është Menyr Lamaj. Ndërkohë, një nga të mbijetuarit ka treguar me detaje për "GSH" se si ndodhi aksidenti. "Shkova të shihja për gjendjen e kushëririt që ishte aksidentuar, kur një makinë na mori të gjithëve para", është shprehur Menyr Lamaj. Ai tha se sapo ishte njoftuar për aksidentin në fjalë ku ishte përfshirë kushëriri i tij, bashkë me të vëllain dhe djalin kishin shkuar nga fs-hati drejt rrugës, ndërsa ishin marrë para nga një makinë. Sipas të plagosurit, makina ishte me shpejtësi dhe nuk kishte frenuar fare. "Na u përplas një kushëri në autostradë. Duke parë atë, na vjen një makinë na merr ballë përballë. Kushëririn e kishte goditur një makinë. E në ato momente teksa ishim duke parë, na vjen makina na merr para. Makina erdhi pas 5 minutash. Ishte me shpejtësi të paparë. As nuk frenoi fare. Ne ishim në këmbë, shkuam të shihnim djalin e xhaxhait që ishte aksidentuar: Ishim në fs-hat, sapo morëm vesh për aksidentin dhe duke parë ambulancën në rrugë, na mori makina para. Isha unë, djali dhe vëllain im. Edhe ata u goditën. Ishin shumë persona, nuk e di", tha Lamaj teksa ndodhet i shtruar në spitalin e Fierit, ndërsa në fytyrë ka ende njolla gjaku.


# DOSJA "HABILAJ" PERGJIMET

Zyrtarët e policisë të përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike, përgjimet

## Dosja e "Habilajve", zbardhen bisedat mes anëtarëve të grupit

### Mojsiu, dy italianëve të peshkarexhës 'Fatima': Këtu jeni si në shtëpi, nuk ka probleme

Zbardhet dosja e Nazar Seitit, i akuzuar si sekser i grupit të Habilajve për trafikim të lëndëve narkotike. Prokuroria e Krimeve të Rënda ka përfunduar hetimet për vlonjatin, ndërsa gjithçka figuron në këto përgjime në lidhje me kultivimin e drogës në rrethin e Vlorës. Të përfshirë në dosje janë emrat e Taulant Haxhirajt, që është cilësuar kultivues e shitës i drogës në bashkëpunim me Renaldo Avdylin, punonjës policie, Xhovalin Baço, Shkëlqim Kociajn, Marjus Bajramin dhe Reshat Radhimën. Prokuroria në 4 tetor 2016 ka bërë kontroll në varrezat mes fshatit Vezhdanisht dhe Treblovë dhe ka gjetur parcela të mbjella me 1430 rrënjë kanabis. Në vijim të saj, në një objekt druri janë gjetur të varura 11 reshta bimë të prera me kërcell e boçe, tre thasë me boçe kanabisi. Në anën jugore të vendit u gjetën dhe 1550 bimë të tjera narkotike. Prokuroria thotë se 600 metra më tej ishte një tjetër parcelë e mbjellë me kanabis. Për trafikimin e drogës nga Shqipëria në Itali kanë bashkëpunuar të pandehurit Mojsi Habilaj, Nazar Seiti, Meridjan Sulaj, Armando Sulaj, Sabaudin Çela, Fatmir Minaj, Tigrens Mezuraj dhe disa të tjerë. Sipas hetimeve, Mojsi Habilaj dhe anëtarët e tjerë janë mbështetur nga punonjës policie e zyrtarë të lartë policie, ku dyshohet edhe ish-ministri Saimir Tahiri, të cilët kanë ndikuar në mosbulimin e tyre. Duke qenë të dyshuar për të njëjtën episod, për dy procedimet penale u vendos bashkimi i tyre në një të



Faksimil e përgjimeve

vetëm me nr.134, i vitit 2016. Ndërkaq, në vitin 2017 në shtëpinë e të pandehurit Armando Koçerri u gjetën 3978 kg kanabis të paketuara dhe arsenal armësh. Bashkëpunëtorë të Koçerrit janë Mojsi dhe Florjan Habilaj, të cilët rezultojnë se kanë pasur komunikime me Koçerri gjatë trafikimit të

narkotikëve për në Itali. Në fabrikën e vajit të Florjan Habilajt në Babicë të Vogël është gjetur një gomone funksionale.

**PERGJIMET**  
**Datë 16.9.2017** Mojsi Habilaj bisedon me një personi të paidentifikuar.  
**Habilaj:** Alo!  
**X:** Hë vlla, ika unë, mora

**HETIMET**  
 Prokuroria e Krimeve të Rënda ka përfunduar hetimet për vlonjatin, ndërsa gjithçka figuron në këto përgjime në lidhje me kultivimin e drogës në rrethin e Vlorës. Të përfshirë në dosje janë emrat e Taulant Haxhirajt, që është cilësuar kultivues e shitës i drogës në bashkëpunim me Renaldo Avdylin, punonjës policie, Xhovalin Baço, Shkëlqim Kociajn, Marjus Bajramin dhe Reshat Radhimën.

dhe kamionin me bërsi.  
**Habilaj:** E more vetë?  
**X:** Jo, shoferi.  
**Habilaj:** E mirë të keqen...  
**X:** Unë po iki me Fatjonin, mora edhe Çimin me vete.  
**Habilaj:** Kë Çim? Çimin e Bodes?  
**Biseda 2**  
**28.9.2017**  
**Gesi:** Alo!  
**Florjan Habilaj:** O Gesi.  
**Gesi:** Sa i kishe dhënë, një të vogël, një dyshe apo jo?  
**Florjan:** Eeee...  
**6.10.2017**  
**X:** Hë vëlla, po iki në Vlorë.  
**Florjan Habilaj:** Ku je tani?  
**X:** Tani po dal nga Babica.  
**Florjan Habilaj:** Do vish në Babicë të Vogël?  
**X:** Këtu jo. Ke ndonjë ash-tu?  
**Florjan Habilaj:** Jo, jo do të tregoj nja dy gjëra të mi bësh nesër, ose kur të kesh kohë.  
**X:** Tani.  
**Florjan Habilaj:** Hajde se jam te fabrika...  
**22.9.2017**  
 Armand Kaçerri çon SMS te një numër: 0692628048, Bir-



bil Maska ma dha numër dovelti tuaj.  
 Më 24 shtator Armandi merr një telefonatë ku i thuhet: "Ka ardhë një motor nga këta të policisë", ndërsa përgjigja e Kaçerri është: "E di". Më vonë ai ka telefonuar një numër tjetër ku i thotë: "Të mora sot se s'ti bëra drutë gati, por kur të vij pastaj, i marr ato bar-bunjat unë". Më pas rezultojnë përgjime ku i tregojnë këtij se ka pasur vizita nga persona të panjohur.  
**6.10.2017**  
 Kaçerri telefonon Florjan Habilajn.  
**Kaçerri:** Hë vëlla, ç'po bën?  
**Florjan Habilaj:** Po pi raki.  
**Kaçerri:** Kam 170 kg fra-toj (ulli që bëjnë vaj të mirë), të duhen?  
**Florjan Habilaj:** Jo që duhen nesër. Do ndez fabrikën, të them unë.  
**Ora 8.37 e darkës**  
**Florjan Habilaj:** I thuj Arsenit të të thotë ty t'i çojë te fabrika. Jo i thuj, mo gënje më i thuj. I thuj Arsenit se po gënjeve, nuk merr asnjë kokërr ar.  
**Kaçerri:** Po jo ore, ç'punë ke ti vëlla, ti ke punë me mua.  
**Florjan Habilaj:** Se dëgjo-va që të tha Arseni t'i çoj te fabrika.  
**Kaçerri:** Jo ore.  
**30.09.2017**  
 Kaçerri telefonon Mojsi Habilajn  
**Kaçerri:** Hë vëlla, ç'a bën, Andi jam, ç'a bën?  
**Mojsi Habilaj:** Kaçerri.

**Kaçerri:** Doja të takoja një cikë, të pyesja për dikë.  
**Mojsiu:** Në Babicë do jem.  
 05.10.2017 Kaçerri me Florjan Habilajn në telefon.  
**Kaçerri:** Të marr pak "Toyota" të iki në Babicë të marr pak mish që kam porosit?  
**BISEDA 923**  
**16.10.2017 ora 15.31**  
 Florjan Habilaj merr një SMS me këtë përmbajtje: Shiko lajmet te "Klani".  
**Ora 17.29**  
 Kaçerri merr SMS nga motra: Ca bëtë ju, mbaruat punë?  
**Kaçerri:** Kishe gjë, më thuj?  
**Motra:** Ka dalë te "Fokusi" qendra Babicë e Madhe, që s'është në rregull.  
**Kaçerri:** Po mirë, le të dali.  
**Motra:** Shikoji pak lajmet  
**Ora 19.51**  
 Kaçerri telefonohet nga motra: Po lehin qentë poshtë të shtëpisë së xhaxhait ore...  
**Kaçerri:** OK, po vij te diga jam.  
**Motra:** OK ndaj të mora.  
**Ora 21.49**  
 Kaçerri telefonohet prapë nga motra: Ka njerëz poshtë te ullinjë.  
**Kaçerri:** Kush?  
**Motra:** Po lehin qentë, se di ç'a po bëjnë a po shkulin ullinjë.  
**Florjan Habilaj:** Hajt vëlla.  
 Florjan Habilaj (Lolo) ➔

**Njoftim për shitje me ankand të tretë**  
 SH "Power & Justice" (P&J) sh.p.k. bazuar në nenin 568,577 e vijues te K.P.L.C do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e pales debitore B Kamberaj dhe L. Kamberaj. Pasuria që shifet në ankand përbehet nga:  
 - "Tualet + Godinë", me numër pasurie 14/283 ndodhur në Lagjen 10 Korriku dhe e regjistruar pranë ZVRPP- Vlorë, e ndodhur në Z.K.Nr.8602, volumn 35, faqe 144, me sipërfaqe tualt 300 m2, sipërfaqe e kati përde 117.3 m2. Ankandi i tretë fillon me çmimin fillestar në masën **5.644.800 Lekë**  
 Ankandi gendori i hapur 30 ditë dhe do të zhvillohet në datë **23.01.2019 në orën 15:00** në Bulevard "Sj. Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5, Tiranë. Ofertuesit duhet të kërtojnë dokumentacionin si dhe të kontaktojnë tel. **67 20 82 543** e-mail: **llir\_dervishi@yahoo.com** ose WEB **www.powerjustice.al.com**

**SHPALLJE ANKANDI**  
 Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 21.01.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Arë me nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 ZK, 2326, në Kuman. Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramiaz , me vlerë fillestare në ankand 420,0004(Katerqind e njezet mijë)LEKË...  
 Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit **0672027580, +355 4 22 31 888**, email **enuar.merko@gmail.com**

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**  
**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**  
 A. PASURIA nr. 281 / 10, e lojti "Arë", zona kadastrale 2631, volumn 18, faqe 15, sipërfaqe 1.000 m2, adresë: Mborje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA, Çmimi 2.168.144 Lekë.  
 B. PASURIA nr. 187 / 20, e lojti "Arë", zona kadastrale 2631, volumn 11, faqe 250, sipërfaqe 1.500 m2, adresë: Mborje-Korçë, në pronësi të KOÇO LENA, Çmimi 739.140 Lekë.  
 Data e zhvillimit të ankandit do jetë **14.01.2019**.  
 CEL: 068402666 ; 069326286.





TIRANE

**P**rokuroria e Krimeve të Rënda ka përfunduar hetimet për grupin "Habilaj" dhe ka çuar dje në gjykatë dosjen për 9 të pandehurit e këtij grupi. Bëhet fjalë për shtetasit Moisi Habilaj, Florjan Habilaj, Armando Koçerri, Nezar Seiti, Sabaudin Cela, Tigrens Mezuaraj, Fatmir Minaj, Maridjan Sulaj dhe Armando Sulaj. Ditën e djeshme, avokatët e 9 të pandehurve janë paraqitur në prokurori, ku kanë marrë dëgjim për akuzat që klientët e tyre do të përballen në gjykatë. Moisi Habilaj dhe anëtarët e tjerë të këtij grupi akuzohen për trafik të lëndëve narkotike dhe krijim i grupit të strukturuar kriminal. Në dosjen e prokurorisë të siguruar nga "GSH" thuhet se këta persona kanë bashkëpunuar me ish-zyrtarë të lartë të policisë, si Jaeld Çela, Gjergji Kohila e Sokol Bode si edhe ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Ndërkaq, mësohet se prokuroria është në pritje të dy letërporosive për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Burimet thanë për "News 24" e "Gazeta Shqiptare" se në fundjavë dy prokurorët Dritan Prençi dhe Vladimir Mara kanë udhëtuar drejt Italisë, ku i kanë komunikuar akuzën drejtuesit të këtij grupi, Moisi Habilaj dhe Nazer Seitit, i njohur si financieri i "Habilajve". Ndërkohë, janë veçuar hetimet për ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, për të cilin organi i akuzës ka kohë deri më 17 janar për t'u shprehur se çfarë do të bëjë me të.

← telefonohet nga nr. X në ora 18.34, datë 16.10.2017.

X: Lolo ça bën vlla, Astri-ti jam.

Florjan Habilaj: Hë ore dajo, ça bën?

X: Është e vërtetë kjo që dëgjojmë?

Florjan Habilaj: Eeee... ti?


X: Hajt mos e çaj b... i marshin të keqen se llafe janë...

Përgjimet në peshkarexhën "Fatima", në të cilën ndodheshin Guliano dhe Greco, të cilët do priteshin nga Moisi Habilaj për t'u kaluar në tokën shqiptare. Pasi u ankoura peshkarexha "Fatima", Moisi Habilaj hipi në bord dhe u dha italianëve udhëzimet: "Tani marrim naftën një herë, fillojmë me bidoonat... këtu je si në shtëpinë tënde.... boll... nëse vjen dikush? Nuk kemi pse të rrimë dy orë sipër, më kuptove"? Bisedat e para vënë në dukje se Moisiu komunikonte me forcat lokale të policisë, si dhe të një punonjësi të centralit operativ në Tiranë. Moisiu i jep direktiva italianëve pas ngarkesës se nga cili korridor duhet të kalojnë, duke i shpjeguar se informacioni ishte nga policia. Nga hetimet rezultoi se Florian Habilaj, Moisi Habilaj dhe anëtarët e tjerë të grupit kriminal për ushtrimin e veprimtarisë kriminale kanë bashkëpunuar me zyrtarë të lartë të Policisë së Shtetit, Jaeld Çela ish-drejtor i Vlorës, Gjergj Kohila ish-shëf sektori për hetimin e trafiqeve në Vlorë; Sokol Bode. shefi i policisë kufitare Dhërmi dhe ish-ministri Tahir. Në bazë të kësaj mbështetjeje, ky grup ka mbjellë e trafikuar lëndë narkotike, thuhet në dosjen e Krimeve të Rënda.

Dy letërporosi mbajnë peng çështjen "Tahiri", afati për vendimin deri më 17 janar

# Përfundojnë hetimet për grupin "Habilaj", çohet në gjykatë dosja për 9 të pandehurit

*Prokuroria e Krimeve të Rënda: Akuzohen për trafik droge dhe krijim të grupit të strukturuar kriminal*



**PERSONAT E PANDEHUR TË DOSJES "HABILAJ"**

1. Moisi Habilaj
2. Florjan Habilaj
3. Armando Koçerri
4. Nezar Seiti
5. Sabaudin Cela
6. Tigrens Mezuaraj
7. Fatmir Minaj
8. Maridjan Sulaj
9. Armando Sulaj



Ish-ministri Saimir Tahiri



Moisi Habilaj

**AKUZA**

Nënte të pandehurit e dosjes "Habilaj" akuzohen për trafik të lëndëve narkotike dhe krijim i grupit të strukturuar kriminal. Në dosjen e prokurorisë, të siguruar nga "GSH" thuhet se këta persona kanë bashkëpunuar me ish-zyrtarë të lartë të policisë, si Jaeld Çela, Gjergji Kohila e Sokol Bode si edhe ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Ndërkohë, janë veçuar hetimet për Tahirin, për të cilin organi i akuzës ka kohë deri më 17 janar për t'u shprehur se çfarë do të bëjë me të.

dojnë akuzat e trafikut të narkotikëve në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal; krijimit të grupit të strukturuar kriminal dhe kryerje të veprave nga organizata kriminale. Të njëjtat akuzat janë ngritur edhe mbi supet e pesë të pandehurve të tjerë, mes tyre edhe Armando Koçerri, pronarit të magazinës në Babiç të Vlorës,

ku më shumë se një vit më parë u kap një sasi rekord prej 4 tonë hashash. Në dosjen e prokurorisë që disponon "GSH" thuhet ndër të tjera se: "të pandehurit Florian e Moisi Habilaj si dhe anëtarët e tjerë të grupit kriminal, për ushtrimin e veprimtarisë kriminale, kanë bashkëpunuar me zyrtarë të lartë të policisë së kohës; bëhet fjalë për

të shumëkërkuarit Jaeld Cela, Sokol Bode e Gjergj Kohila. Në një episod, përgjimet telefonike konfirmojnë se 'bimët narkotike të prera nga ana e policisë janë lënë të padëmtuara dhe pjesëtarët e këtij grupi i kanë marrë më pas'. Nga këqyrja e telefonit të Taulant Haxhirajt, i dënuar më herët nga gjykata, rezultoi se ai bisedoi me një tjetër anëtar të grupit, duke shkruar se çdo gjë bëhet "me shtet". Këto përgjime, sipas prokurorisë provojnë faktin se aktiviteti kriminal zhvillohej me dijeninë e Policisë së Shtetit. Më tej, në dokumentin e institucionit të akuzës flitet edhe për bashkëpunim të grupit kriminal me ish-ministrin e Brendshëm Saimir Tahiri, i cili është nën hetim prej më shumë se një vit e tre muaj. Por, edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë, grupi prej tre prokurorësh nuk ka dalë ende me një vendim për fatin e ish-ministrit. Vendimarrja ka mbetur peng

i përgjigjes së dy letërporosive nga Italia dhe Mali i Zi. Nëpërmjet njërës prej letërporosive pritët informacion lidhur me një udhëtim të familjarëve të Tahirit nga Shqipëria drejt Italisë, në korrik të 2014-ës, për faktin se në të njëjtin avion me të si në vajtje, ashtu edhe kthim ka udhëtuar edhe Moisi Habilaj. Letërporosia pritët t'i japë përgjigje pyetjes nëse udhëtimi ka qenë rastësor, apo ka njohje të afërta mes familjarëve të ish-ministrit dhe vëllezërve Habilaj, marrëdhënie që në fakt janë mohuar nga Tahiri. Afati për përfundimin e hetimeve për ish-ministrin e Brendshëm është 19 janari, por me gjasë, prokurorët do të marrin sërish kohë. Pas përfundimit të hetimeve nga ana e prokurorisë, avokati Detar Hysi që mbron interesat e Nezar Seitit, i kontaktuar nga "News 24" tha se ky është një 'servilizëm' i prokurorëve për të kaluar vetëngul. Sipas tij, në këtë mënyrë po dhunohen të drejtat e njeriut.

# SIGURIMI SHËNDETËSOR RIMBURSIMI

FSDKSH: Barnat me rimbursim, kush mund t'i marrë falas ose me 50% zbritje

## Sigurimi shëndetësor, ja përfitimet që do të kenë pensionistët

Zbardhen kategoritë që përfshihen në skemë

Voltiza Duro

Të gjithë ata qytetarë që paguanë kontributet për sigurimet shëndetësore, kanë të drejtë të përfitojnë rimbursimin e barnave si dhe mund të marrin disa shërbime mjekësore falas. "Gazeta Shqiptare" publikon sot përfitimet që mund të kenë pensionistët, invalidët e plotë apo dhe kategori të tjera individësh falë sigurimit shëndetësor: "Masa e kontributit të sigurimit të detyruar shëndetësor është 3,4% e bazës për llogaritjen e kontributeve. Për të punësuarit, kontributet paguhën, në masën 50% (pesëdhjetë për qind) nga punëdhënësi dhe në masën 50% (pesëdhjetë për qind) nga i punësuar. Si bazë për llogaritjen e kontributit shërbën paga bruto e personit të siguruar"- thekson Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor: Ky i fundit, gjithashtu, nënvizon se kontributi i shtetit për personat ekonomikisht joaktivë bazohet në konsumin për frymë të shërbimit shëndetësor, indeksuar me koeficientin e inflacionit.



### KATEGORITË PËRFITUESE

Çdo shtetas që paguan kontribut për sigurim shëndetësor, ose për të cilin paguan shteti, është i siguruar dhe përfiton nga skema e sigurimeve shëndetësore. Karta e Shëndetit është dokumenti i vetëm që vërteton se personi është i siguruar në skemën e sigurimeve shëndetësore. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe pagesa e kontributeve përkatëse janë të detyrueshme për të gjithë personat

ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Shqipëri, si të punësuarit; personat e vetëpunësuar; punonjësit e papaguar të familjes; apo dhe persona të tjerë ekonomikisht aktivë. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon, gjithashtu, kategoritë e personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj. Në këtë kategori përfshihen bëjnë pjesë: personat që përfitojnë nga Instituti i

Sigurimeve Shoqërore; personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës; personat e regjistruar si të papunë- punëkërkues në Shërbimin Kombëtar të Punësimi; shtetasit e huaj azilkërkues në Republikën e Shqipërisë; fëmijët nën moshën 18 vjeç; nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomik; kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta; viktimat e trafikimit, sipas identifikimit të bërë nga strukturat e Ministrisë të Punëve të Brendshme si dhe personat e siguruar vullnetarisht.

### LLOJET E PËRFITIMEVE

Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen: vizitat mjekësore pa pagesë në institucionet shëndetësore publike; vizitën falas në banesë kur gjendja shëndetësore e të sëmurit nuk mundëson paraqitjen në institucionin shëndetësor; ekzaminimet mjekësore në institucionet shëndetësore publike; si dhe trajtimet mjekësore pa pagesë në spitalet publike. Gjithashtu, sigurimi i detyrueshëm mundëson edhe shërbimet e paketave shëndetësore në institucionet shëndetësore private të kontraktuara me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; rimbursim të plotë ose të pjesshëm të barnave të Listës së Barnave të Rimbursueshme në varësi të kategorisë. "Me konkretisht për barnat, personat e siguruar, ose nuk paguajnë fare ose kanë një pagesë të pjesshme që shkon deri në 50% të cmimit të barnave, por jo më shumë. Kategoritë si: pensionistët, invalidët të plotë, fëmijë 0 - 12 muaj, të sëmurë me CA, TBC, të verbër përfitojnë falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në listë. Kategoritë si: veteran dhe invalidë të luftës, përfitojnë falas në masën 100% të gjitha barnat e listës së rimbursueshme, si dhe të gjitha barnat e tjera të regjistruara në Republikën e Shqipërisë"- nënvizon FSDKSH. Pra, nëse jeni pensionistë, invalidë, veteranë, të punësuar, të vetëpunësuar, të siguruar vullnetarisht, fëmijë, gra



### SHËRBIJMET NGA SIGURIMI SHËNDETËSOR

#### ► Kategoritë përfituese

#### Persona ekonomikisht aktivë:

- ◆ të punësuarit;
- ◆ personat e vetëpunësuar;
- ◆ punonjësit e papaguar të familjes;
- ◆ persona të tjerë ekonomikisht aktivë.

#### Personat ekonomikisht joaktivë:

- ◆ personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
  - ◆ personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës;
  - ◆ personat e regjistruar si të papunë- punëkërkues në Shërbimin Kombëtar të Punësimi;
  - ◆ shtetasit e huaj azilkërkues në Republikën e Shqipërisë;
  - ◆ fëmijët nën moshën 18 vjeç;
  - ◆ nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomik;
  - ◆ kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta;
  - ◆ viktimat e trafikimit, sipas identifikimit të bërë nga strukturat e Ministrisë të Punëve të Brendshme.
  - ◆ Personat e siguruar vullnetarisht
- #### Përfitimet
- ◆ Vizitat mjekësore pa pagesë në institucionet shëndetësore publike, që financohen nga sigurimi shëndetësor dhe në respektim të sistemit të referimit;
  - ◆ Vizitën falas në banesë - kur gjendja shëndetësore e të sëmurit nuk mundëson paraqitjen në institucionin shëndetësor;
  - ◆ Ekzaminimet mjekësore në institucionet shëndetësore publike;
  - ◆ Trajtimet mjekësore pa pagesë në spitalet publike;
  - ◆ Shërbimet e paketave shëndetësore në institucionet shëndetësore private të kontraktuara me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
  - ◆ Rimbursimi i plotë ose i pjesshëm i barnave të Listës së Barnave të Rimbursueshme në varësi të kategorisë; Me konkretisht për barnat, personat e siguruar, ose nuk paguajnë fare ose kanë një pagesë të pjesshme që shkon deri në 50% (për qind) të cmimit të barnave, por jo më shumë.
  - \*Kategoritë si: pensionistë, invalidë të plotë, fëmijë 0 - 12 muaj, të sëmurë me CA, TBC, të verbër përfitojnë falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në listë.
  - \*Kategoritë si: veteran dhe invalidë të luftës, përfitojnë falas në masën 100% të gjitha barnat e listës së rimbursueshme, si dhe të gjitha barnat e tjera të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.



### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

#### NJOFTIM PËR EKSPERTË DHE SPECIALISTË TË PAVARUR

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Vendimit të KPP-së nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", KPP shpall konkurrimin për plotësimin e listës vjetore të Ekspertëve dhe Specialistëve të Pavarur në fushat:

Ekspert vlerësimi i pasurive të paluajtshme; ekspert kontabël i regjistruar; inxhinier elektronik/informatik; inxhinier mekanik; inxhinier hidrologjik; inxhinier elektrik; inxhinier gjeologji-minierash; inxhinier mjedisi; inxhinier ndërtimi; inxhinier tekstil; kimist; specialist në farmaceutikë.

#### Kandidati duhet të plotësojë kërkesat:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën ku ai do të konkurrojë.
2. Të ketë liçensë në fushat ku ligji parashikon pajisjen me të.

Pagesa dhe shpenzimet e ekspertëve apo specialistëve të pavarur do të bëhet me parapagim nga pala ankimese.

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 08 Shkurt 2019 në selinë e Komisionit të Prokurimit Publik këto dokumenta: kërkesën për aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, fotokopje të liçensës si ekspert, të librezës së punës, vërtetimin e gjendjes gjyqësore, fotokopje të kartës së identitetit, numër kontakti, si dhe adresën e plotë të vendbanimit

shtatzëna, persona që trajtoheni me ndihmë ekonomike, punëkërkues etj. me anë të kartës së shëndetit mund të përfitoni nga skema e sigurimeve shëndetësore, duke fillu-

ar nga recetat e rimbursueshme, shërbimi të mjeku i familjes, të mjeku specialist, në qendrat spitalore, pra në të gjithë sistemin tonë shëndetësor publik.



### PROPOZIMET DHE DOKUMENTACIONI

Do të pranohen të gjitha propozimet e dërguara nga:

- Shoqatat e mjekëve,
- Shoqatat e farmacistëve,
- Firmave farmaceutike prodhuese,
- Përfaqësitë e firmave prodhuese,
- Shërbimi shëndetësor parësor,
- Klinikat e QSU "Nënë Tereza".
- Komisioni i Nomenklaturës së Barnave
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

**Për propozimet e klasës A1, A2, A3 duhet:**

- Evidenca përkatëse shkencore (për shembull, fotokopje të artikujve të literaturës aktuale, shqiptare ose botërore, konkluzione të forumeve shkencore vendase apo çdo e dhënë tjetër mbi të cilat mbështetet propozimi).

**Për propozimet e klasës A4 duhen:**

- Të dhëna lidhur me efikasitetin e barit të propozuar, krahasuar me efikasitetin e barnave ekzistues në Listën e Barnave të Rimbursuara (për shembull, fotokopje të artikujve të literaturës aktuale, shqiptare ose konkluzione të forumeve shkencore vendase apo çdo e dhënë tjetër).
- Të dhëna mbi profilin e efekteve anësore të barit të propozuar, i krahasuar me atë të barnave ekzistuese në Listën e Barnave të Rimbursuara (për shembull, fotokopje të artikujve të literaturës aktuale, shqiptare ose konkluzione të forumeve shkencore vendase apo çdo e dhënë tjetër).
- Krahasimi i kostove të mjekimit me barin e propozuar dhe barnat ekzistuese në Listën e Barnave të Rimbursuara. Për propozimet e klasës B1 dhe B2 duhen:
  - Frekuenca/incidenca e sëmundjes mundësisht në vendin tonë.
  - Roli dhe specifika terapeutike të barit që propozohet në trajtimin e sëmundjes.
  - Të dhëna lidhur me formdozën, rrugën e administrimit, dozën ditore, kriteret e fillimit ose të mbarimit të mjekimit.
  - Kriteret që tregojnë realizimin e efektit të pritur.
  - Të dhëna mbi profilin e efekteve anësore të barit të propozuar.
  - Kosto e mjekimit

"Përfitojnë pacientët me sëmundje, trajtimi i të cilave është i rimbursuar"

# Ndryshime në listën e barnave me rimbursim, kategoritë përfituese

FSDKSH: Kush mund të dërgojë propozimet, afati i fundit

Voltiza Duro

Brenda vitit 2019-të, pritet të ketë disa ndryshime në listën e barnave të rimbursuara. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ka bërë me dije se afati i dorëzimit të propozimeve për ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara është deri në 15 janar të këtij viti. "Afati i dorëzimit të propozimeve për ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara është deri më datë 15.01.2019, ora 16:30. Pas kësaj date propozimet nuk do të pranohen. Propozimet për ndryshime në LBR duhet të dërgohen nëpërmjet shërbimit postar. Dorëzimi i propozimeve do të bëhet pranë Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në adresën, Rruga "Sami Frashëri", Nr. 8, Tiranë, nëpërmjet protokollimit në zarf të mbyllur, drejtuar "Komisionit Teknik të Listës së Barnave të Rimbursuara". Materiali shkencor plotësues që shoqëron kërkesën mund të jetë bashkëlidhur, edhe në formë elektronike (CD)", thekson FSDKSH.

### PROPOZIMET

FSDKSH bën me dije se do të pranohen të gjitha propozimet e dërguara nga: Shoqatat e mjekëve, Shoqatat e farmacistëve, Firmave farmaceutike prodhuese, Përfaqësitë e firmave prodhuese, Shërbimi shëndetësor parësor, Klinikat e QSU "Nënë Tereza", Komisioni i Nomenklaturës së Barnave dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Ndërkohë në njoftim bëhet me dije se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi dhe shoqatat e pacientëve me status, nuk janë të detyruara të paraqesin propozimet sipas formatit të mësipërm.

### KATEGORITË

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor thekson se propozimet për ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara mund të jenë të dy kategorive: ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara për sëmundje, trajtimi i të cilave është i rimbursuar. Dhe ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara për sëmundje, trajtimi



### KATEGORITË

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor thekson se propozimet për ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara mund të jenë të dy kategorive: ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara për sëmundje, trajtimi i të cilave është i rimbursuar. Dhe ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara për sëmundje, trajtimi i të cilave rimburohet pjesërisht ose nuk rimburohet.

### NDRYSHIMET

Ndryshimet në Listën e Barnave që Rimburohen për sëmundje trajtimi i të cilave rimburohet pjesërisht ose nuk rimburohet, mund të konsistojnë në: përdorimi i një bari të Listës së Barnave që Rimburohen për indikacione që nuk lejohen nga kriteret e Listës së Barnave që Rimburohen; përfshirja e një bari në Listën e Barnave që Rimburohen për trajtimin specifik të sëmundjes.

i të cilave rimburohet pjesërisht ose nuk rimburohet. "Ndryshimet në Listën e Barnave të Rimbursuara për sëmundje, trajtimi i të cilave është i rimbursuar, mund të konsistojnë në: Ndryshime të kriterëve të Listës së Barnave që Rimburohen; Ndryshime të dozave apo protokolleve të përdorimit të një bari të Listës së Barnave që Rimburohen; Shtimi i një alternative tjetër brenda grupit Kimiko-farmakologjik ose terapeutik.", nënvizon FSDKSH. Më tej kjo e fundit bën me dije se alternativa brenda grupit Kimiko-farmakologjik nënkupton një bar që nuk është në Listën e Barnave që Rimburohen, që nga struktura kimike dhe/ose vetitë farmakologjike ngjason dhe ka të njëjtin indikacion me një bar të Listës së Barnave që Rimburohen. "Për shem-

"Afati i dorëzimit të propozimeve për ndryshime në Listën e Barnave të Rimbursuara është deri më datë 15.01.2019, ora 16:30. Pas kësaj date propozimet nuk do të pranohen. Propozimet për ndryshime në LBR duhet të dërgohen nëpërmjet shërbimit postar", thekson FSDKSH.

bull, bari Lisinopril është alternativë e barit Captopril dhe Enalapril. Alternativë

brenda grupit terapeutik. Ky term nënkupton një bar, që nuk është në Listën e Barnave që Rimburohen dhe përdoret për të njëjtin indikacion që përdoret edhe një bar i Listës së Barnave që Rimburohen. Për shembull: bari Chlorphenamine është alternativë e barit Cetirizine (trajtimi i rinitit alergjik), -shton më tej Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Ndryshimet në Listën e Barnave që Rimburohen për sëmundje trajtimi i të cilave rimburohet pjesërisht ose nuk rimburohet, mund të konsistojnë në: përdorimi i një bari të Listës së Barnave që Rimburohen për indikacione që nuk lejohen nga kriteret e Listës së Barnave që Rimburohen; përfshirja e një bari në Listën e Barnave që Rimburohen për trajtimin specifik të sëmundjes. Për këtë qëllim propozimi duhet të klasifikohet në një nga klasat e mësipërme, d.m.th: A1, A2, A3, A4, B1 ose B2.

## PROTESTA E MINATORËVE KERKESAT

Ish-punonjësi i nëntokës: Qeveria do të marrë grushtin përfundimtar nga populli

# Mark Pepa: Minatorë zgjohuni, bashkohuni në protestë deri në miratimin e statusit

"Hiqni dorë nga sindikatat dhe partitë politike"

Voltiza Duro

Në protestën e studentëve para Kryeministrit ditën e djeshme janë bashkuar edhe një grup minatorësh. Këta të fundit prej vitesh kërkojnë dyfishimin e pensionit për shkak të vështirësisë në punë si dhe miratimin e statusit të minatorit. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Mark Pepa, ish-punonjësi i nëntokës tregon se për vite me radhë qeveritë janë tallur me gjakun e kësaj kategorie duke iu premtuar shumë, por duke mos ndërmarrë asnjë veprim konkret. Pepa thekson se nëse vazhdohet kështu, së shpejti qeveria do të marrë grushtin përfundimtar nga minatorët, studentët e vetë i gjithë populli.

**Ditën e sotme (djeshme) minatorët iu bashkuar protestës së studentëve. Pse erdhi një vendim i tillë nga ju?**

Me ngritjen e studentëve në protestë, është një shans për ne që të ngremë zërin. Studentët janë fëmijët tanë, bëjnë tanë dhe ne i mbështesim. Vetëm këta të rinj mund ta sjellin ndryshimin dhe ne besojmë tek ata. Të gjithë së bashku mund të ngremë zërin për një Shqipëri më të mirë, për një sistem më të mirë, ku populli, qeveria e deputetët të jenë në shërbimin tonë e jo në shërbim të tyre si tani.

**Cilat janë kërkesat kryesore të minatorëve dhe pse ky ngërç prej kaq shumë vitesh?**

Problemi madhor i minatorëve ka lindur që prej qeverisjes nga Partia Demokratike. Jemi e vetmja shtetë që kemi vuajtur më shumë se të gjithë dhe absolutisht nuk duhet të barazohet statusi i minatorit, as me statusin e naftëtarit, as me të metalurgut, ne kemi hyrë me qindra metra nën tokë dhe e kemi pasur jetën në fije të perit. Shumë kolegët tanë kanë humbur jetën e s'kanë gëzuar as pensionin, veçanërisht minatorët e Kurbneshit. Minatorët në Kurbnesh nuk kishin siguri për jetën e shprehja e tyre kur hynin nëntokë ishte "dalçim shëndosh". Shumica prej tyre nuk kanë arritur të marrin pensionin, sepse punonin e thithnin pluhurin e kuarcit, tepër i rrezikshëm për shëndetin. Shumica kanë shkuar maksimumi 48-50 vjeç e dhe vetë pensionin nuk e gëzuan. Prej vitesh, ne minatorët kërkojmë dyfishim të pensionit me vendim qeverie.

**Ju prej kohësh kërkonte miratimin e statusit. Cili**



Ish-punonjësi i nëntokës, Mark Pepa

**ka qenë reagimi nga instancat përgjegjëse lidhur me kërkesat tuaja?**

Kryeministri në fush-

atën e vitit 2013 dhe në fushatën pasardhëse, disa herë ka deklaruar se do të miratojë statusin e minatorit.

Por vitet kanë kaluar dhe asgjë s'ka ndryshuar për ne, vetëm premtime dhe asnjë veprim. Ministrat e minis-

trive përgjegjëse vetëm na kanë mashtruar, ashtu siç na ka mashtruar vetë Rama. Unë jam një nga ata që kam qenë në takim me vetë kryeministrin Rama. Kërkoj timonin, ia dhamë dhe i besuam. Por mesa duket, është mbytur në teps me oligarkët e tij dhe timoni është ndryshkur dhe nuk po orientohet drejt familjeve në nevojë.

**Cilat do të jenë hapat e mëtejshëm që do të ndërmerri?**

Ne nuk jemi dele dhe ka ardhur koha që të marrim një përgjigje të saktë. Në të kundërt, nëse nuk plotësohen kërkesat tona, Rama duhet të ikë sa më parë nga kreu i qeverisë. Nëse vazhdohet kështu, së shpejti qeveria do të marrë grushtin përfundimtar nga mina-

torët, studentët e vetë i gjithë populli. Mjaft luajtën këto 3 parti, na kanë vjedhur, mashtruar, masakruar, por tani po iu vjen fundi. Ky sistem ka sjellë këto pasojë kaq të rënda mbi popullin. Po pasurohen oligarkët e po varfërohet populli. T'i japin fund njëherë e mirë këtij kapitulli. Shokët tanë kanë humbur jetën për të nxjerrë pasuritë nga nëntoka, ndërkohë që pushtetarët po pasurohen në kurrizin tonë.

**Cila është thirrja juaj ndaj të gjithë minatorëve?**

Minatorët duhet të bashkohet të gjithë, të mos rrinë në shtëpi, pasi nuk do t'u vijë asnjë dhuratë nga shteti. Të çohen, të dalin në shesh e të kërkojnë të drejtat, të protestojnë krahas studentëve deri në miratimin e statusit.

## Mark Gjergji: Kemi dëgjuar pallavra nga zyra e kryeministrit

"Mjaft më, të miratohet statusi, ose Rama të largohet"

Voltiza Duro

Minatorët nuk do të pranojnë asnjë lloj negociate me qeverinë deri në plotësimin e kërkesave të tyre dhe miratimin e statusit të minatorit. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", minatori në pension Mark Gjergji tregon se do të qëndrojë pranë studentëve dhe do të protestojnë së bashku me ta. Ai më tej hedh akuza mbi çdo qeveri që ka qeverisur këto 28 vjet dhe i fajëson për situatën në të cilën punonjësit e nëntokës ndodhen sot. Gjergji thekson se pavarësisht bashkëbisedimeve me koordinatoren e bashkëqeverisjes pranë Kryeministrit dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave, deri më tani kanë marrë vetëm premtime dhe asgjë konkrete.

**Pse i jeni bashkuar protestës së studentëve?**

Ne kemi ardhur në protestë në mbështetje të studentëve, pasi po protestojmë për dy kauza të njëjta, për një qëllim. Ne minatorët dhe



Minatori në pension, Mark Gjergji

gjithë qytetarët e Shqipërisë paguajmë për studentët, ata janë bëjtë tanë. Për të shkolluar fëmijët tanë na është dashur të marrim lekë borxh

për të larë tarifën e universitetit të fëmijëve. Ne s'kemi para për të mbajtur veten tonë, mezi na dalin për ushqime e jo më të paguajmë sh-

kollat e fëmijëve.

**A do të vijojë protesta juaj deri në miratimin e statusit?**

Nuk do të pranojmë asnjë lloj bashkëbisedimi apo negociate me qeverinë. Do të vazhdojmë të protestojmë me minatorët dhe me studentët, pasi jemi për një qëllim, për përmirësimin e kushteve, si për studentët, edhe për minatorët. Është një kauzë shumë e drejtë. Ne, nismëtarët e miratimit të statusit, si grup interesi jemi të bashkuar dhe do të qëndrojmë e luftojmë deri në fund për plotësimin e kërkesave tona.

**Cila është përgjigja që ju kanë dhënë instancat përgjegjëse lidhur me kërkesat tuaja?**

Kjo tradhti ndaj minatorëve ka ardhur nga çdo qeveri, si majtas ashtu edhe djathtas. Ka disa vite që luftojmë për të drejtat e minatorëve dhe kemi marrë vetëm zhgënjime dhe mashtrime nga çdo qeveri. Kemi pasur një takim me koordinatoren e

bashkëqeverisjes pranë Kryeministrit, por vetëm na tregojnë "përralla me mbret", deri tani s'kemi parë asgjë konkrete. Ministria e Financave po na jep vetëm një "karamelë" si për të na mashtruar me kaq. Ne kërkojmë veprime konkrete, jo pallavra.

**Cila është thirrja juaj ndaj qeverisë dhe shtetit shqiptar?**

Dua t'i them Edi Ramës që nëse nuk plotëson kërkesat tona, kërkesat e studentëve dhe ato të gjithë popullit shqiptar, ka për t'u rrezuar shumë shpejt nga karrigia. Ne jemi minatorët, ata që i kemi dhënë më shumë këtij shteti, por na varfëruan qeveritë e këtyre 28 viteve. Kemi 11 vite që po luftojmë e ngaqë sindikatat tona janë të korruptuara, detyrohemi të dalim vetë e të luftojmë. Boll më! Ose Rama të na japë të drejtat që na takojnë, ose të largohet nga posti i kryeministrit!

## Aleksandar Vučić merr medalje nderi nga Vladimir Putin

### Presidenti rus dekoron homologun serb me Urdhrin e Shën Aleksandër Nevskit

Një ditë para takimit të tyre, Presidenti rus Vladimir Putin ka vendosur të dekorojë me Urdhrin e Shën Aleksandër Nevskit, homologun e tij serb, Aleksandër Vučić. Lajmi është bërë i ditur nga websajti zyrtar i Kremlinit, i cili raporton se Putin ka firmosur sot dekretin mbi ndarjen e Urdhrit të Shën Aleksandër Nevskit. "Aleksandar Vučić shpërblehet për kontributin e tij të madh personal në bashkëpunimin shumëpalësh me Federatën Ruse", thuhet në deklaratën e Kremlinit. Sipas Tanjugut, kjo njohje iu dha një serbi pas gati 100 vjetësh. Vučić nga ana tjetër tha se për të do të ishte një nder i madh, të marrë një vlerësim që nuk është fituar nga asnjë serb në 100 vitet e fundit.




Takimi i Putin me Vučić

#### DEKLARATA RUSE

"Aleksandar Vučić shpërblehet e tij të madh personal në bashkëpunimin shumëpalësh me Federatën Ruse", thuhet në deklaratën e Kremlinit.

het për kontributin e tij të madh personal në bashkëpunimin shumëpalësh me Federatën Ruse", thuhet në deklaratën e Kremlinit. Sipas Tanjugut, kjo njohje iu dha një serbi pas gati 100 vjetësh. Vučić nga ana tjetër tha se për të do të ishte një nder i madh, të marrë një vlerësim që nuk është fituar nga asnjë serb në 100 vitet e fundit.



#### Hoxhaj: Mbështetja ruse ndaj Serbisë ndikon keq në rajon

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj i është kundërpërgjigjur deklaratave të ministrit të Jashtëm serb, Ivica Dačić për mbështetjen pa kushte të Rusisë ndaj shtetit serb. Përmes një postimi në Twitter, Hoxhaj është shprehur se mbështetja pa kushte që po i jep Rusia Serbisë, po ndikon negativisht në rajon. Zykryeministri i Kosovës ndër të tjera u shpreh se Rusia duhet të mbajë përgjegjësitë e saj ndërkombëtare, pasi sjellja e saj mund të ndikojë në fragmentarizimin e situatës politike në Ballkan.

### Hashim Thaçi: Ja kur mund të heqë Kosova taksën ndaj Serbisë

# Bruksel, ekipi negociator i Kosovës sot takon Mogherinin

## Dialogu, opozita kosovare refuzon t'i bashkohet

Ditën e sotme, ekipi negociator i Kosovës me Serbinë, takon në Bruksel Federica Mogherinin, që është ndërmjetësuese në dialogun me Serbinë, që aktualisht ka ngrirë. Ekipi negociator refuzohet nga opozita. Ekipi negociator i Kosovës takohet sot në Bruksel me të ngarkuarën e BE-së për politikën e jashtme evropiane, Federica Mogherini. Grupi negociator i Kosovës që kryesohet nga Fatmir Limaj dhe Shpend Ahmeti, udhëton në Bruksel për herë të parë që nga mandati i tij në Kuvendin e Kosovës në nëntor të vitit të shkuar, me gjithë kundërshtimin e partive opozitare. Çështja e të pagjeturve është tema e vetme e konfirmuar që do të diskutohet në Bruksel, ndërsa, thuhet se ky takim i pari i këtij lloji me shumë cilësohet si një takim konsultues, sesa negociues. "Shërbimi i Jashtëm Diplomatik (EEAS) ka ftuar Ekipin e Dialogut nga Kosova për konsultime, më 8 janar, pas themelimit të tij nga Kuvendi", citohet të ketë thënë Maja Kocijançiq, zëdhënëse e Federica Mogherinit. Ndërkohë, njëri nga kryesuesit e ekipit negociator të Kosovës, Fatmir Limaj, para nisjes ka thënë se "në Bruksel, do të tregojnë përkushtimin e Republikës së Kosovës për vazhdimin e dialogut me Serbinë". "Do të shkojmë për të dëshmuar vullnetin dhe gatishmërinë e Kosovës për dialog. Më tepër është një takim konsultativ, për të parë dhe për të informuar njëri-tjetrin, se si do të vazhdojmë me dialog. Do t'i paraqesim qëndrimet e delegacionit të Kosovës në Bruksel", ka thënë zëvendëskryeministri i Kosovës Fatmir Limaj, duke bërë të ditur se ekipi negociator është i koordinuar mirë edhe për temat, për të cilat do të flitet në Bruksel. Nga ana tjetër, ekipi dialogues i Kosovës ndeshet me kundërshtimin e ashpër të partive politike opozitare. Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe lëvizjen Vetëvendosja. Këto dy subjekte politike thonë se "ky delegacion nuk përfaqë-




Federica Mogherini, Aleksander Vučić, Hashim Thaçi

son vullnetin e shumicës qytetare", pasi "ai përbëhet nga parti shumë të vogla". Nënkrjetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, kërkon që opozita të japë kontributin e saj për ta përmbyllur shtet-ndërtimin e Kosovës. Gjatë fundjavës ka pasur akuzë e kundër-akuzë nga vetë krerët e partive politike në pushtet dhe të atyre në opozitë lidhur me pjesëmarrjen-përkatesisht-mospjesëmarrjen e opozitës në grupin e dialogut, edhe pse në këtë grup ata kanë dy vende të rezervuara. Nënkrjetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, tha se "asnjëherë nuk është vonë për LDK-në ta japë kontributin e saj për ta përmbyllur shtet-ndërtimin e Kosovës". "Është momenti i fundit për LDK-në që të zgjidhet nga gjumi i thellë, në të cilin ka

rënë dhe të mos i përsërisë gabimet e së kaluarës, duke qenë në bisht të proceseve politike dhe historike. Dua të besoj se brenda kësaj partie ka vullnet, dije dhe guxim për të vepruar në interes të vendit duke u bërë bashkë që të merremi me Serbinë dhe jo me njëri-tjetrin. Por duket që problemi është diku tjetër - nuk ka një mendim të prerë dhe të vendosur për asgjë", shkroi Enver Hoxhaj. I menjëhershëm ishte reagimi i kryetarit të LDK-së, Isa Mustafa, i cili tha se LDK, nuk do t'u shërbejë partive në pushtet. "Lidhja Demokratike e Kosovës është parti e Kosovës: shtet-formuese, institucionaliste, e qendrës së djathtë. I merr vendimet vet. Të gjithë atyre që bregosen dhe derdhen lotë krokodili për LDK-në, nga fakti se LDK nuk po iu shërben dhe nuk do tu shërbejë interesave të tyre push-

tetore dhe kolaboracioniste, u them se ata mund të vazhdojnë ta kritikojnë LDK-në, sepse ky është edhe një argument shtesë se nuk kemi asgjë të përbashkët me ta. LDK është e Kosovës dhe ajo vendos vetë si do t'i shërbejë në mënyrën më të mirë Kosovës", -shkroi kreu i LDK-së Isa Mustafa. Sidoqoftë, dialogu i drejtpërdrejt Kosovë-Serbi tash për tash është i ngrirë që nga koha kur qeveria e Kosovës ngriti taksën prej 100 për qind për mallrat serbe që hyjnë në Kosovë. Autoritetet e Serbisë thonë se ato nuk marrin pjesë në dialog, derisa Prishtina ta heqë taksën. E qeveria në Prishtinë sipas kryeministrit Ramush Haradinaj, "nuk e ka ndërmend që ta heqë taksën", përdërsa siç thotë, "Serbia ta ndalë agresionin politik e diplomatik ndaj shtetit të Kosovës". Disa shenja më optimiste

vijnë nga presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, i cili tha se "nëse i jepet rrugë e qartë dialogut me synim arritjen e një marrëveshje finale me Serbinë, Kosova mund ta shqyrtojë mundësinë e heqjes së taksës". "Kosova është gati të shqyrtojë heqjen e taksës për produktet serbe nëse Kosovës i jepet një rrugë e qartë drejt arritjes së një marrëveshjeje finale paqësore me Serbinë, i kam thënë gazetës "The Washington Post", duke kërkuar që SHBA-ja të marrë rol udhëheqës në koordinimin e inputit ndërkombëtar për Marrëveshjen Paqësore finale që do të sjellë njohjen e Kosovës nga Serbia. Ndërgjegjia jonë na kërkon - dhe është detyrë e jona historike - që të bëjmë paqen të mundshme dhe të vërtetë", shkroi në profilin e tij Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Nga ana tjetër, Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi në një intervistë dhënë për gazetën amerikane "The Washington Post", ka folur edhe për taksën që Kosova i ka vendosur produkteve të Serbisë dhe Bosnjës. Thaçi përmes një postimi në profilin e tij zyrtar në rrjetin social "Facebook", ka sqaruar edhe një herë deklaratën e tij dhënë prestigjiozes amerikane. "Kosova është gati të shqyrtojë heqjen e taksës për produktet serbe nëse Kosovës i jepet një rrugë e qartë drejt arritjes së një marrëveshjeje finale paqësore me Serbinë, i kam thënë gazetës "The Washington Post", ka shkruar Thaçi ndër të tjera në postimin e tij.



#### Asnjë datë për hapjen e urës në Mitrovicë

Ura kryesore e lumit Ibër, e cila qytetin e Mitrovicës e ndan në veri dhe në jug, ishte planifikuar të hapet për qarkullim të automjeteve dhe të njerëzve më 4 mars 2017. Federica Mogherini kishte ardhur në Mitrovicë për ta përmirësuar urën, por kryetari i komunës veriore, Goran Rakiq, kishte kundërshtuar. Edhe pas dy vjetëve ura mbetet e mbyllur, ndërsa Bashkimi Evropian ende nuk ka ndonjë datë për hapjen e saj, shkruan sot gazeta "Zëri". Ndonëse punët në revitalizezim e urës mbi lumun Ibër, si dhe të rrugës "Mbreti Peter" në veri që moti kanë përfunduar, projekti 3.1-milionësh i Bashkimit Evropian nuk ka shkuar deri në fund, pasi ura nuk është hapur për qarkullim të automjeteve dhe të njerëzve. "Teknikisht punimet për revitalizimin e urës kryesore dhe rrethinave të saj në Mitrovicë kanë përfunduar. BE-ja po punon si në Beogradin, ashtu edhe me Prishtinën. Të gjitha marrëveshjet e dialogut që kanë të bëjnë me urën do të zbatohen tërësisht sa më shpejt që është e mundur", thuhet në përgjigjen e Zyrës së Bashkimit Evropian.

Dritë në fund të tunelit, merr drejtim lajmi më i përfolur i "showbizz"-it

# E vërteta e lidhjes së Flor Mumajsesit me Kejsi Tolën, çfarë i bën bashkë dy artistët e njohur

*Ja postimet e kantautorit për këngëtarën*

Egla Xhemali

Të gjithë sytë tek ai! Që pas fitores së bujshme në festivalin "Kënga Magjike", kantautori i njohur Flor Mumajesi është vënë në epiqendër të mediave rozë për një lidhje të mundshme me këngëtarën Kejsi Tola. Burime për "Gazeta shqiptare" kanë pohuar se atë janë vetëm bashkëpunëtorë, megjithatë çifti nuk ka pranuar gjë ende. Nuk ka pasur asnjë reagim nga artistët për të përgënjeshtuar lajmin. Ndërkohë që Flori me krijimin e tij i këndonte një dashurie që s'është më dhe që shumë aluduan se bëhej fjalë për Elvana Gjatën, nga ana tjetër, dukej se ajo që e ngushëllonte ishte Kejsi Tola me këngën "Më ke mua", një krijim po ashtu i Mumajesit, që fitoi çmimin e "Produksionit më të mirë". Në fakt, ishte vetë këngëtarja, ai që e ktheu të gjithë vëmendjen te jeta e tij personale me postimet në "Instagram". Flori publikoi një foto nga momenti kur interpreton me Kejsi Tolën këngën "Më ke mua", te "Post Kënga Magjike", në studion e të "Dielës shqiptare", ku shfaqeshin shumë të afërt me njëri-tjetrin. Teksa Kejsi këndonte, Flori e përqafoi, i drej-



tohej me fraza nga teksti i këngës, bënte gjeste romantike dhe kaq është dashur që të përflitet se ata janë në një lidhje. Por, ajo që shton më shumë dyshimet, është fotoja e publikuar disa ditë më parë nga Flori në "Instastory"-n, ku shfaqet Kejsi në studiot e xhimit, foto, të cilën këngëtarja e ka shfaqur me një emoji zemër.

Kaq ka mjaftuar dhe mediata konsiderojnë këtë një romancë të fshehtë, që tashmë doli në sipërfaqe me dëshirën e vetë Florit, si për të larguar vëmendjen nga alibia se ai në këtë festival erdhi për t'i dhënë një mesazh publik ish-bashkëpunëtores së ngushtë në muzikë, Elvana Gjatës, duke i thënë "S'kena me u

pa më bashkë". Ajo që e ka trazuar edhe me këtë aludim ka qenë vetë Kejsi fill pas publikimit të produksionit të fundit të Florit. Asokohe kur sapo ishte publikuar "U rritëm" e këngëtarja ishte duke shijuar suksesin e saj në klasifikimin e "The Top List", i bëri të gjithë konfuzë me postimin në "Instagram":




"Kjo është një këngë që e kam dashur që nga fillimi kaq shumë dhe jam kaq e lumtur që po më bëni ta vazhdoj ta dua edhe më shumë, nga çdo koment dhe çdo fjalë me kaq shumë energji, shkruante Tola. Kantautori ka preferuar të krijojë afrimet me një artiste 10 vite më të re në moshë. Edhe pse ka dalë në skena

të mëdha që në adoleshencë, Kejsi deri më tani nuk është përfolur ndonjëherë për lidhje me meshkuj të botës së "showbiz"-it. Nëse i kthehemi edhe një herë festivalit "Kënga Magjike", të dy artistët u ngjiten në skenë më në formë se kurrë dhe me trofe. Sa i përket lidhjes së mundshme mes të dyve do na ngelet të presim.




## "Vajza ruani mashkullin tuaj", Enca i habiti të gjithë me postimin e saj

Këngëtarja Enca Haxhia është një artiste mjaft e pëlqyer nga publiku dhe ndër personazhet më të komentuar nga mediat rozë. Enca i habiti të gjithë fansat me anë të një postimi që bëri në "Instastory". Ajo postoi një foto përkrahë një mashkulli, të cilit fytyrën ia kishte mbuluar me emoji. Mjaftoi kjo gjë dhe në mediat shqiptare qarkulloi lajmi se ai është i dashuri i ri i Encës dhe bëhet fjalë për një emër jo të panjohur për publikun shqiptar. Por pas këtyre fjalëve, Enca ka reaguar nëpërmjet një postimi në "Instastory", ku përgënjeshton fjalët dhe shprehet se ajo nuk do e publikojë kurrë në rrjetet sociale të dashurin. "Ju ujqër, edhe kur të kem të dashur, unë nuk do e postoj kurrë atë në 'Instagram'. Vajza, ruani mashkullin tuaj", - shkruan këngëtarja.



## Më në fund e pranoi! Mësoni me kë është i dashuruar këngëtarja i njohur

Është një ndër reperët më të përfolur në mediat rozë kohët e fundit dhe tashmë ai e pranoi se është i dashuruar. Reperi nisi pyetje/përgjigje me ndjekësit në "Instastory", përmes së cilave zbuloi disa gjëra rreth vetes. Njëri nga ndjekësit e pyeti 'a je i dashuruar' dhe Majk u përgjig me 'po', mirëpo më pas vijon pyetja e radhës 'me kë je i dashuruar' dhe ai tha 'me jetën', raporton "Prive". Pyetjet dhe përgjigjet e shumta nuk ekzistojnë më në profilin e tij, pasi Majk i fshiu ato. Ndërkohë, dikush e pyeti reperin se nëse do ta merrte në ndonjë klip djalin e tij, Roanin dhe përgjigja e Majkit ishte 'të rritet edhe pak'. Ju kujtojmë se Majk dhe Roan e nisën 2019-ën bashkë dhe për këtë reperi dukej mjaft i entuziazmuar, pasi publikoi vazhdimisht foto me të birin në "Instagram".



## Superhiti i verës! Xhensila dhe Ardian Bujupi kanë një arsye më shumë për të festuar

Artistët e njohur të askenës shqiptare, Xhensila Myrtezaj dhe Ardian Bujupi, për herë të parë bashkëpunuan së bashku vitin që lamë pas. Në kohën kur këngëtarja ishte shtatzënë, Ardiani e ftoi për këngën "Çika Çika", një këngë e cila bëri bujë që në momentin e publikimit të saj, e ndërkohë sot në "YouTube" shënon 70 milionë klikime. Këtij lajmi iu gëzua tej mase Xhensila, e cila e ripostoi këngën në "Instastory"-n e "Mumës", i cili u përkujdes për tekstin. Gjithashtu, përveç klikimeve, numri është i madh edhe tek pëlqimet dhe komentet.



## Pas shkatërrimit të grupit, Noizy thumbon Getoarin me këtë detaj

Kompania muzikore e krijuar nga reperi Getoar Selimi e njohur me emrin "Babastars", prej disa ditësh është në krizë. Por ndërkohë që mediat po vijnë prej nga këto lajme, Ghetto Geasy vazhdon të shijojë pushimet dimërore në krah të bashkëshortes së tij, prezantueses Marina Vjollca në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çifti i njohur i "showbiz"-it gjendet përtej oqeanit që prej fillimit të këtij viti dhe një nga postimet e Getoarit ishte në një helikopter dhe përdori si dëfturë "flight mode". Nëse ju kujtohet, një ndër këngët më të pëlqyera të Noizyt është pikërisht "Flight Mode" me Lil Koli. Dhe me siguri pasi fansat i kujtuan Getoarit në këtë postim se "Flight Mode" është kënga e Noizyt, ky i fundit publikoi një video nga kënga, por që më pas u fshi. Pra, ishte një "thumb" për Getoarin meqë përdori tekstin e tij?



## BOTIMI

Naum Prifti

# NAUM PRIFTI:

## Një jetë me personazhet e Roald Dahl

Miqësia ime mbi tridh jetëvjeçare me shkrimtarin me origjinë norvegjeze filloi kur Brikena Cabej, aso kohe Drejtuesja e Redaksisë së Jashtme sikurse quhej Redaksia e Përkthimeve në Tiranën e periudhës para ndërrimeve politike, më dha për recension romanin "THE BIG FRIENDLY GIANT". E dija se Roald Dahl ishte shkrimtar norvegjez, i cili shkoi në Angli qysh kur ishte fëmijë dhe aty u rrit, edukua dhe shkollua. Romani më mahnti me fantazinë dhe humorin e derdhur natyrshëm. Ishte e qartë se përkthimi kërkonte më shumë se njohje të gjuhës angleze, për të mos humbur shpotinë e gjuhës dhe vlerat e përmbajtjes. "Gjuha fantastike" e gjigantit nuk më hiqej nga mendja dhe shpesh përsëritja me vete variante të tingëllimit të shprehjeve të tij në shqip. Kur Brikena më tha se nuk mund të gjente dikë që ishte edhe përkthyes edhe humorist, gjiganti dhe unë nisëm rrugën drejt hyrjes në panteonin e përkthimeve humoristike. Roald Dahl është mjeshër i lojës me fjalë dhe togfjalësia, me kompozita, me parashitesa dhe prapashitesa. Sa për të dhënë një shembull, autori vë në gojë e gjigantit fjalë si HUMAN BEANS në vend të HUMAN BEING, që në shqip do të përkthehej nga QENIE NJERËZORE në NJERI FASULE duke humbur humorin e frazës. Natyrisht, shqipërimi shkante më larg se përmbajtja gjuhësore. Për të ruajtur humorin dhe për të arritur efektet përkatëse komike të veprës origjinale, së pari m'u desh të mësoja teknikën e humorit anglez të përdorur nga Dahli në veprën e tij, sikurse transpozicionet e rrokjeve brenda fjalës, të cilat ia ndryshonin krejt kuptimin fjalës.


Për një vështrim krahasimor studiova përkthimin e GJMM në gjuhën italiane, ruse dhe franceze. Ndryshe nga dy të parat të shoqëruara me shënime shpjeguese për lojërat e fjalëve, përkthimi më frëngjisht kishte shmangur përkthimin ad verbatim dhe përkthyesi kishte gjetur adekuatet e sakta dhe efektive të gjuhës frënge. Unë vendosa të ndjek një metodë të ngjashme. Gjiganti bën "gabime" të hatashme kur flet, por justifikohet se nuk ka patur fatin të shkojë në shkollë. Kështu në vend të fjalës zarzavate, ai thotë zjarrzavate, në vend të fjalës rinoceront, gjiganti thotë rinoqeros, për misterioze, ai thotë mishorizore, për llafazan ai thotë llafefazan, në vend të gjeputra ai thotë gjel-pula. Së dyti, unë krijova disa neologizma ose modifikime fonetike e kuptimore për t'iu përshtatur morfama të Dahlit. Sa për ilustrim nga pasthirrma Puh, krijova foljen "puhas", si edhe emrin "puhatje," si një veprim që kryhet kur ai i fryn një tubi për të dërguar në dhomat ku flenë fëmijët ëndrrat që ka mbledhur në fushë dhe ata kësajsoj shohin ëndrrat që ka përzgjedhur ai. Gjiganti del ndër fusha e kodra për të kapur ëndrrat dhe i kap ato si flu-



"Njohja ime me autorin 30 vite më parë dhe fjalët e reja"

turat me një shtagë të gjatë që ka në krye një rrjetë teli, pastaj i përzien ato si do vetë, madje disa i bën të frikshme, fyngangushtore, sikurse u thotë atyre që të kallin tmerrin duke të zënë fytyrën apo grykën. Një

shembull tjetër: nga fjala trangull që është ushqimi i zakonshëm i gjigantëve krijova teleshtrangull për t'i dhënë një kuptim më modern me anë të parashtesës "tele" të përdorur në terma të teknikës si tele-



tajp, teleks, televizor. Po ashtu shqipërova dhe emrat e disa gjigantëve si Lokma-llupësi, Plëndcaullja, Ripërtypësi i Kockave.

Përkthimi u mirëprit nga lexuesit dhe kritika, e cila u shpreh me en-

tuziazëm se Naum Prifti e bëri Gjigantin e Madh të Mirë të flasë shqip. Madje disa nga frazat e Gjigantit autodidakt si psh teleshtrangull u përhapën me shpejtësi duke hyrë në përdorimin e përditshëm si qyfyre.

Për mua, përkthimet janë po aq të vlefshme sa edhe krijimet e mirëfillta. Prandaj pas suksesit të Gjigantit, unë përktheva një nga titujt klasik të letërsisë botërore Çarli dhe Fabrika e Çokollatave nga i njëjti autor: Aventurat e z. Vili Vonka, Umpa-Lumpave dhe Çarlit i japin lexuesit kënaqësi si edhe disa mësim praktikë të stilit Dahl-ian. Them se miqësinë e vjetër me krijuesin e personazheve të paharueshme letrare dhe mjeshtrin e lojërave të fjalëve vazhdoj ta ruaj. Bashkëpunimi im i tretë me gjigantun e letërsisë është libri "Çarli dhe Ashensori i Madh prej Xhami" ku historitë e zotit Vonka dhe Çarlit arrijnë stratosferën në kuptimin e vërtetë dhe figurativ të fjalës. Në një shtrirje kohore mbi tri dekada i kam dhënë lexuesit shqiptar mundësinë të shijoj gamën e pasur të fantazisë dhe humorit të Roald Dahl-it në tri vepra klasike: "Gjiganti i Madh i Mirë", "Çarli dhe Fabrika e Çokollatave" dhe "Çarli dhe Ashensori i Madh prej Xhami".

### Libri më i ri, një copëz nga vepra e sapobotuar

Roald Dahl ka ardhur në shqip në një format të madh krejt të ndryshëm nga më parë dhe plot ngjyra! Çfarë ndodhi me Çarli Buketin dhe Vili Vonkën pasi lanë pas Fabrikën e Çokollatave? Ashensori i madh prej xhami po vosit hijshëm lart në qiell, treqind metra mbi Fabrikën e Çokollatave! Vili Vonka, Çarli Buket dhe familja e tij mund ta shohin gjithë botën poshtë tyre. Mirëpo ata nuk e dinë që nuk janë vetëm atje lart! Në hotelin hapësinor SHBA, mrekullia e arrijeve të epokës kozmike, i cili sapo është lëshuar në orbitë, kanë hyrë vermicjet përbindëshe, qeniet më lebetitëse të krejt universit... Me shqipërimin mjeshëror të Naum Priftit, "Çarli dhe ashensori i madh prej xhami" është prej dhjetorit në duart e lexuesve!

#### PJESË NGA LIBRI

Edhe brenda Ashensorit të Madh prej Xhami kishte tollovi. Çarli dhe Vili Vonka e gjithë të tjerët e shihnin qartë siluetën madhështore argjendore të Hotelit Hapësinor "SHBA" gati një milje përpara tyre.

Dhe natyrisht gjithkush, madje dhe gjyshja Xhozefinë, tani e dinte mirëfilli se ç'po ngjiste. Ata madje e dinin se tre astronautët që komandonin Kapsulën Ndërlidhëse quheshin Shakuarth, Shanks dhe Shauler. E gjithë bota i dinte këto gjëra. Gazetat dhe televizionet kishin gjashtë muaj që s'jepnin gjë tjetër: Operacioni Hoteli Hapësinor ishte ngjarja e shekullit...

- Po sikur ata të na vihen nga pas? - foli për herë të parë zoti Buket.

- Po sikur të na kapin? - tha zonja Buket.

- Po sikur të na qëllojnë? - tha gjyshja Xhorzhinë.

- Po sikur mjekra ime të jetë prej spinaqi jeshil? - bërtiti Vili Vonka. - Gjëgjeza dhe gromësira. Nuk arrihet asgjëkundi me psikure të tilla. A do ta kishte zbuluar Kolombi Amerikën nëse do thoshte: "Po sikur të mbytem rrugës? Po sikur të më zënë piratët? Po sikur të mos arrij të kthehem?" Mbase nuk do që nisur fare! Nuk na duhen "psikure" këtu, apo s'e kam mirë Çarli? Përpara pra!



PIKTORI

# NASER HASA

## Vizatimi, themeli i gjithçkaje

Nga Luan Rama

Në një nga letrat që Van Gogh i dërgonte vëllait të tij Theo, ai i shkruante se "Ditën që njerëzit do të fillojnë të thonë se unë di të vizatoj, pra jo të pikturoj, atëherë ndoshta unë do të bëj një pikturë, në një cast të papritur për ta". Van Gogh thekson, gjithashtu, se "në praktikë, metoda është të ushtrosh në fillim vizatimin, pasi mund të kalosh shumë më lehtë nga vizatimi në pikturë, sesa anasjelltas".

Këto fjalë të Van Gogh-ut, djaloshi i ri i pasionuar pas vizatimit, Hasa ndoshta nuk i ka lexuar në atëkohë në Kosovë, por ishte vizatimi që e çoi atë drejt një pikturë të mirëfilltë dhe vizatimi duket se mbetet për të kyçi i artit të tij. Ka piktore që edhe pse vizatues mjaft të mirë e braktisin vizatimin në mesin e krijimtarisë së tyre, por ky piktori i Ballkanit, ardhur nga Ulqini për të ekspozuar disa nga veprat e tij në Paris, duket se nuk do ta braktisë, madje rikthimi i vazhdueshëm drejt vizatimit i jep atij impulse të reja dhe ajo që është më me interes, është se vizatimi e çon akoma më thellë drejt portretit psikologjik. Pra, piktori Hasa ka përshkuar e vazhdon të përshkojë atë trajektore për të cilën shkruante para më shumë se një shekulli Van Gogh, trajektore që nisi në shkollën e pikturës në Prishtinë, me pikëtakime në Beograd dhe Zagreb, duke formuar gradualisht një profil spikates mes piktoreve të kësaj pjese të Ballkanit. Sigurisht, baza e kulturës së tij figurative ishte laboratorit krijues pranë atelierit të profesorit të tij Muslim Mulliqi, një nga piktoret kosovare më me influencë të gjenratës së viteve '50 - '70 të shekullit XX, krahas Rexhep Ferrit apo Tahir Emra. Ishin këto koncepte të reja të mjeshtrisë së vizatimit që e frymëzuan atë për të krijuar personalitetin e tij piktural dhe një vepër origjinale si në telajo ashtu dhe në fletën e vizatimit. E megjithatë, e përsëris se veprat e tij më të mira duket se mbeten portretet në vizatim, krijime këto me një ekspresivitet jo të zakonit. Por edhe krijimet në ngjyra, kanë dhe ato një origjinalitet të veçantë: edhe pse pa dicitura ato të ofrojnë impresione të shumta, herë një det në flakë apo një natyrë që vibron në stuhitë (1998, 2003) e herë një tablo e ndarë në dy nivele, ku trupat e tri femrave përviçojnë poshtë në një kërlëshje trupash, duke i dhënë tablosë një ndarje kohore. Shpesh ai na paraqet një botë të habitshme kromatike, një shpërbërje ngjyrash që vetëm një fëmijë duket se i ka parë në një kaleidoskop marramendës dhe me një



ngazëllim të hatashëm. Skena të gëzuara, gra me një dinamikë lëvizjesh, asnjëherë statike, scena të jetës së përditshme e ndonjëherë një dehje nudos për të kundruar bukurinë femërore. Por le t'i rikthehem përsëri disa portreteve në vizatim çka përbëjnë një zbulim të kësaj ekspozite. Një portret femre mbi të cilën janë hedhur njolla dhe lapsi ka shtuar një mori vijash që në pamje të parë krijojnë një lloj kaosi të organizuar, shpërqendrimi, por duke qëndruar fare pak para tablosë, portreti të ofrohet me një psikologji ku të lejohet të imagjinosh nëse ajo kokë është e trishtë, mediton, apo është pas një çasti ekstaze... Një tjetër vizatim, një portret ku dora piktorit ka vizatuar gjithë dhembjet e tij dhe një klithje që ne e dëgjojmë, apo një tjetër vizatim, ku një trup njerëzor me këmbë të hapura ngri-



het si një lloj demoni duke humbur kryet në një qiell me re dhe në një botë të trazuar... Sidoqoftë, ajo që mbizotëron në krijimtarinë e tij është portreti. Ai nuk vizaton një portret akademik, por kërkon



gjithnjë të kapet pas karakterit të dhënë në pak linja, që në gjetjen e parë, intuitive, shprehëse e perso-



nale, herë-herë njolla e vija që në të tërën krijojnë atë çka portretizohet në atë hapësirë ku, është piktori dhe përfytyrimi i tij. Kështu, arti i këtij piktori na rrëmben drejt botrash të tjera...

### TEATRI EKSPERIMENTAL SHFAQ MONODRAMËN "DOME"

"Dome" është një monodramë e shkruar enkas për aktorin e Teatrit "Migjeni" të Shkodrës, Enver Hyseni. Shkrimi i saj është produkt i një vëmendje të zgjuar gjatë bisedave të gjata mes autorit dhe aktorit ndër procese pune apo ndenjen të rastesishme. Ajo që i ka bërë përshlytje autorit gjatë këtyre bisedave ka qenë gjithmone sinjeriteti i thellë me të cilin Enver Hyseni tregonte aspekte të ndryshme të jetës së vet, që rrinin të lidhura ngushtë me epokën, së cilës i përkisnin. E kanë përshlytur gjithashtu edhe thjeshtësia e tregimit e veçanarisht mungesa e milleteve dhe inateve. Si çdo person tjetër edhe Enver Hyseni e ka jetuar kohën e vet herë ndër margjina e herë në kryeradhë; e ka jetuar brenda tragjizmit dhe komikës; e ka jetuar në

varfëri dhe në lavdi; vetëm dhe me shokë; me mish e me shpirt. Pra autori ka dashur të shkruajë e më vonë të ndërtojë një shfaqje të thjeshtë, "shfaqje aktori", një shfaqje që të ngjasojë si një akt rrefimi, pse jo edhe kërkimi ndjesë, pardoni, si një gjest që kaq shumë i mungon shoqërisë sonë.

Stefan Çapaliku u lind në Shkodër, në vitin 1965. Më 1988 diplomohet për filologji shqipe në Universitetin e Tiranës. I pason studimet në Itali, Çeki dhe Angli. Në vitin 1996 përfundon doktoraturën në Universitetin e Tiranës. Nga vitin 1993 deri në vitin 1998 ka qenë profesor i Letërsisë në Universitetin e Shkodrës. Nga viti 1998 deri në vitin 2005 ishte drejtor i Depar-

tamentit të Librit në Ministrinë e Kulturës. Që nga viti 2005 punon si studiues në Akademinë e Studimeve Albanologjike në Tiranë. Nga viti 1995 merret sistematikisht me teatër. Tekstet dhe shfaqjet e tij janë dhënë në disa festivale ndërkombëtare, ku është nderuar me çmime. Disa nga veprat e tij janë përkthyer në gjuhët kryesore europiane. Stefan Çapaliku u shpall nga Ministria e Kulturës si dhe nga ente të tjera të specializuara. Si dramaturgu më i mirë për vite me rradhë. Kohët e fundit krijimtaria e tij është shtrirë edhe në fushën e regjisë së teatrit dhe film-it. Është kryeredaktor i revistës "Studime për artin".

Enver Hyseni lindi në Shkodër

më 1 Gusht 1951. Merr mësimë aktorimi në Institutin e Lartë të Arteve për një periudhë të shkurtë (1973-1974) dhe i ndërpret studimet për arësye ekonomike. Më 1975 nis punën në Teatrin "Migjeni" të Shkodrës, ku edhe pensionohet më 2016. Në këtë periudhë dyzetvjeçare luan më se gjashtëdhjetë role në teatër e katër në filma. Punon me regjisorë si Serafin Fanko dhe shquhet për role karakteresh. Zëri tipik dhe plastika e brëndshme e bëjnë një aktor krejtësisht të veçantë dhe interesant. Muzika e maestro Haig Zacharian është një ndër elementet gjithashtu të çmuara të kësaj shfaqje.

Opinion

i Ditës

# Po mbledhim ca fonde, po kujt t'ia dërgojmë!?

Nga Andon Andoni

(vijon nga faqja 1)

... i kishave shqiptare, në të cilën morën pjesë 190 delegatë, që përfaqësonin 52 kisha dhe bashkësi fetare dhe ku Noli u dorëzua peshkop, ndërsa Kostë Çekrezi shqiptoi me zë të lartë fjalët në anglisht: "Dita e sotme ringjalli kishën e shenjtë të Ilirisë" dita e Ujit të bekuar, 6 Janari, i kushtohet mirëbërjes dhe ndihmës, filantropisë, kur njerëzit ndihmojnë për rimëkëmbje, përparim dhe prosperitet duke derdhur në një arkë të quajtur "Ilaso", fonde monetare për qëllimet e mësipërme.

Ndoshta për koincidençë, tamam në këtë ditë, më bie telefoni nga përtej oqeanit nga bashkëfshatarët që jetojnë e punojnë në Amerikë, të cilët më kërkoi që t'iu shkruaja disa radhe, në llojin e një kanunoreje, mbi bazën e të cilës, do hapnin një llogari bankare për të mbledhur të ardhura për rregullimin e fshatit tonë, në lindje të Korçës.

Ja do t'i mbledhim, por kujt t'ia dërgojmë!?


Në realitetin e pas viteve të demokracisë, në fshat, gjithnjë e më shumë, kanë mbetur vetëm pleq e plaka, prifti dhe Kryeplaku. Të rinj në moshën e punës, - sa gishtat e një dore.

Nisma të tilla, fort të pëlqyera për të ndihur vendlindjen, kanë bërë që të përmenden me levdata, në meshën e prift Viktorit, në Zicisht.

Në këtë 6 Janar, kujtoi dhe shoqërinë "Shën Trinia" të 1923-it, të themeluar po për këtë qëllim, - rindërtimin e fshatit. Kujtoi që pas këtij viti themelues, brenda pak kohësh, me mjetet monetare të grumbulluara, (sipas të dhënave të gazetës "Telegraf"(1926) shumat më të mëdha i dhanë kurbetçinjtë e Greqisë se sa ata të Amerikës, dhe ndaj të cilëve kishte goxha qejfmbetje) u ndërtuan të gjitha rrugët e fshatit me kalldrëm. U ngrit ndërtesa e shkollës dhe u martuan disa vajza të familjeve pa përkrahje.

Por le të kthehemi tek thelbi i të sotmes.

Ja mirë, do marrim ca para nga njerëzit tanë, sidomos ata që janë më në gjendje ekonomike, emigrantët, por çdo bëjmë me to?! Fshati ka goxha nevojë për më shumë para nga sa mund të dërgojnë bashkëfshatarët?! Ka nevojë për investime në rrugët, sheshin, mbrojtjen e Lumit nga erozioni, por kush do ta vendosë radhën e tyre më të domosdoshme. Gjer tani, me mbështetjen e vete fshatarëve dhe me në krye prift-



in, kryeplakun dhe dy tri burra në moshën e punës, janë ndërtuar çakallet dhe dy çezmat e fshatit, me punëtorë të ardhur nga fshatrat përreth, por sipas disave, kërraba ka tërhequr më shumë nga punë që mund të prisnin për më vonë, dhe rregullimi i urës treqindvjeçare me qemer, në mes të fshatit është urgjente...Mund të numëronim edhe plotë të tjera si mbrojtja e Lumit të madh dhe rregullimi i

sheshit të fshatit si dikur me piste vallëzimi rrethuar nga shelgjet lotues, por edhe këto mund të rezultojnë subjektive?!

Emigrantët tanë janë plot mall dhe sy e veshë ndaj jetës së fshatit, dhe do donin të shihnin se kontributet e tyre u përdorën mirë dhe me efikasitet. Mundësia e koordinimit të dëshirave të tyre me një përkujdesje të pushtetit vendor do ishte një nga gjërat më të mira. Tani, pas gati

tri dekadave, Vendori është shumë më i konsoliduar dhe do ndihmonte edhe vetë në këto punë. Si me fonde, por edhe me projekte dhe logjistikë të dobishme. Më prezencën e vet, do bënte që kërraba e atyre që jetojnë në fshat dhe ju tërheq nga vetja për të shtruar rrugicën përpara portës dhe ndrequr avllinë, do mbetej varur në gozhdë?! Them kështu dhe sërish më vjen ndër mend një kohë e shkuar, kur dardharët kurbetçinjtë në Amerikë, vetëm pak më tej se zicishtarët e mi, më 1918, mblodhën aq para sa të ndërtonin shkollën e fshatit, që është dhe sot e kësaj dite ndërtesa më e madhe dhe me e bukur e Dardhës. Në fshat, fondet e mbledhura ia besuan Vangjelit, ndër të vetmit që pat mbetur në fshat. I dhanë edhe një defter dhe e mësuan të mbante llogaritë për paratë që do shpenzonin e në do të duheshin të tjera, dardharët mërgimtarë, ishin gati.

Dhe Vangjeli, si i justifikoi gjysmat e fondeve për gurë e llac, ustallarë dhe trarë, për të tjerat, iu tha se i kishte prishur për kafe për ustallarët!?

Nuk them që fondet të mos i përdorin vetë fshati dhe njerëzit e tij, por tani që ka një organizim të diasporës në rang ministrie, me ndikim edhe mbi pushtetin vendor, mundet që fare mirë të vendosen disa ura komunikimi dhe bashkëpunimi midis, mërgimtarëve, pushtetit vendor dhe komunitetit të fshatit që do përdorë investimet.

Është pak e pashpjegueshme se si dhe pse tek ne, komuniteti hedh sytë nga veprat e kultit dhe besimit, dhe edhe kur ato sociale, kulturore, shëndetësore, arsimore, mund të jenë ngjitur me muret e kishës dhe xhamisë, të mbetura në pikë të hallit, gjenden jashtë vëmendjes se tij. Justifikimi: - ato i përka-shtetit t'i mirëmbajë. A thua se ato djem e vajza që bëjnë kryq dhe temena në veprat e kultit, nuk janë ata që ulen në bankat e prishura dhe në shkollën me dyer e dritare të shqyera?

Nga ana tjetër, duke pasur mirëkuptimin dhe dorën ministrorë të Diasporës, në koordinimin e nevojave dhe mundësive mes palëve, emigrantë dhe vendas, edhe bashkëfshatarët e mi do marrin të njëjtat libra dhe këndime për të mësuar gjuhën e mëmës, që nga Amerika, Evropa e Kanadaja, njëlloj, dhe jo të dërguara nga gjyshërit copa - copa? Kësisoj, jo vetëm që paratë e bijve dhe bijave emigrant nuk do bëhen kafe për ustallarët, por me ndihmën e ekspertëve të shtetit, do kenë preventivë të saktë dhe punët do bëhen me këmbë në tokë, duke përpunuar mundësitë me realitetin e investimeve dhe shërbimeve që do kryhen. Madje për punë të ndryshme botore, fare mirë koordinimet do të jenë jo vetëm më efikase, por të dy palët do ndjehen pjesëmarrës në realizimin e investimeve dhe shërbimeve ndaj fshatit dhe qytetit.

Fuqizimi i Ministrisë së Diasporës, për të qenë përbashkuese e mundësive, por dhe e zgjidhjes së halleve mes palëve; emigrantë nëpër botë dhe të mbetur në mëmëdhe, është sot një nga domosdoshmëritë me efikase.

Ditë më parë, një apel të tillë bënte edhe mësuesi Sokol Demaku, që kishte ardhur për të tërhequr një sasi librash për 62 nxënësit e shkollave të mësim-it të gjuhës shqipe në Boras të Suedisë. Politikat shtetërore duhet të koordinohen dhe të paraprijnë në jetën e emigrantëve shqiptarë kudo në botë. Ato sigurisht janë të ndryshme në vende të ndryshme, por kur ka frymë dhe dashuri mëmëdhetarie në mes, gjithçka është e mundur.

Opinioni *i* Ditës

# Kuaj të ndërruar, shpresë e mërguar

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... dhe përpjekjet e saj për t'i bërë të jetojnë më mirë, por kjo nuk po ndodh. Qytetarët e kuptojnë se po të mos kishte qenë protesta trejavore e studentëve në dhjetor 2018, e cila e tronditi nga themelet qeverisjen, karroca qeveritare si zor të ndërronte qofte dhe një kalë të vetëm në stacionin e Vitit të Ri 2019. Ata brenda karrocës ndiheshin ngrohtë me rrezatimin virtual qeveritar, me reformën e thellë në arsimin tonë të lartë, me një ligj të përsosur të vitit 2015, njësoj siç e kanë gjeranët dhe francezët, apo me rritjen ekonomike katër për qind, ndër më të lartat në rajon. Pavarësisht se të 129 mijë studentët e arsimit të lartë publik ndiheshin më të rrjepur se kurrë më parë, nga tarifatat e ngritura dhe shërbimet e tjera të krijuara. Pavarësisht se më të varfrit ndiheshin akoma dhe më të varfër, ngaqë 4 përqindëshin e rritjes ekonomike e përblanin më zëngjinët, ata që në i quajmë oligarkë dhe që në tre vitet e fundit kishin shtuar pasuritë e tyre me një mesatare 11 për qind. Deri përpara 4 dhjetorit të protestës së studentëve ngelës, qeveria notonte në vetëkënaqjen e punëve të mëdha të Bashkëqeverisjes me qytetarin, të zgjidhjes së qindra halleve të njerëzve vetëm nga marrja seriozish e ankesave të tyre online prej një ekipi realisht të ndershëm. Mirëpo me dhjetëra mijëra halle dhe ankesa të tjera ngeleshin pa zgjidhur, ose vonoheshin në zgjidhje edhe më shumë, duke shtuar pakënaqësinë mes njerëzve, tani që pritshmëritë Bashkëqeverisja i kishte rritur në maksimum. Dhe koordinatorët e Bashkëqeverisjes nisën të duken si anëtarët e kontrolleve punëtore e fshatare të një epoke tjetër, për nga përqsasja gati donkishoteske për të zgjidhur problemet e njerëzve. Duke mos parë dështimin në pritshmëritë e njerëzve, ideatori i kësaj qasjeje i gëzohej gëzimit të atyre qindrave që u zgjidhjet halli, duke mos kuptuar se qasja ishte thjesht një sprovë populiste, dhe jo zgjidhje reale, e cila duhej të vinte nga ndry-



shimi i sistemit. Prandaj dhe në këto ditë e para të këtij viti, njësoj si në korrik 2017, pasi mënjanoi partinë e tepsisë dhe e mori timonin i vetëm, i kthehet sërish idesë për ndryshime në administratë. Atëherë hoqi brenda ditës drejtorët e hipotekave dhe vërtet ngjalli shpresë. Tani po e ngroh si një diell korriku në këto ditë acari siberian ideja e studentëve të shkëlqyer të 9-ës dhe 10-tës që të futen ku të duan në administratën shtetërore. Por me një dallëndyshe nuk vjen pranvera. Ndryshimi i vërtetë ndodh kur kryhen reformat të thella, kur ato procedura në dukje kaq dixhitale e perëndimore për të rekrutuar njerëz të rinj në administratën shtetërore sot, kontrollohen vërtet. Dhe, më së fundi,

të krijohet ai mjedis antibiotik për të mos lejuar trukimet që kanë bërë këto gjashtë vitet e fundit të futen militantë partie apo jarane ministrash gati po me atë ritëm kur futeshin me pusulla letre nga bojarët partiakë në periudhën 1992-2012. Qeveria nuk ka asnjë reflektim se pse duhej të bllokohej 1.2 miliardë euro në katër projekte rrugësh me koncesion, kur rrugët e reja mund të pritej edhe disa vjet të bëheshin (nuk është se nuk kemi akse rrugore tani!) dhe me këto para mund të ndihmoheshin shumë më tepër me dhjetëra mijëra bujq apo sipërmarrës të vegjël në turizëm. Ky investim po që të kthehet shpejt, që nuk ka nevojë për të rënduar taksat e sotme dhe të 10 apo 20 viteve

që vijnë, dhe që prodhon me dhjetëra mijëra vende pune në dy sektorë më premtues të ekonomisë sonë. Nëse nuk ndryshon sistemi dhe nuk kthehet përgjegjshmëria në administratën shtetërore nëpërmjet ligjit për përgjegjësinë materiale të nëpunësit publik, që KLSH ka pesë vjet që rreket të bindë ligjëvënësit tanë ta përgatisin e miratojnë, nëse nuk anulohen kontratat koncesionare të porsalidhura, qoftë edhe me gjoba dhe paratë publike të shkojnë në ekonominë e gjithë shqiptarëve, jo në xhepat e oligarkëve ndërtime, atëherë shpresa se ky vend bëhet do të vijojë të ngelet e mërguar në nevojën për teknike që ka tregu gjerman ose në lotarinë amerikane.

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Sot ju do të zgjoheni me shumë energji dhe ndoshta dëshironi të mos humbisni kohë në asgjë. Por, për të qenë i sigurt, duhet të prisni deri më vonë para se të hyni në veprim.

**DEMI**  
Nuk i dihet se çfarë pritet të dalë nga një marrëdhënie e re që fillon sot, prandaj mos i hidhni shpresat shumë larg në të ardhmen. Ta marrni çdo ditë siç vjen është një provë e vërtetë e durimit tuaj.

**BINJAKET**  
Ju keni një energji të pabesueshme që depërton brenda jush dhe mund të shpërthejë sot në një mënyrë shumë të lumtur. Për ta përdorur sa më mirë të gjithë entuziazmit tuaj, përpuni të zhytini në projekte.

**GAFORJA**  
Ju duhet ta përdorni fuqinë tuaj përdërisa e keni atë, sepse nuk mund ta merrni atë si të mirëqenë. Kjo nuk është dita e duhur që të tregoheni dorështrënguar me energjinë tuaj.

**LUANI**  
Kur një makinë bllokohet në dëborë ose baltë, duhet ta shyni para dhe mbraja derisa të mund ta lëvizni. Të njëjtin gjë bëni edhe me jetën tuaj nëse ndiheni i pashpresë. Shenjat reale të progresit do arrijnë me ritëm të shpejtë.

**VIRGJERESHA**  
Bëni një hap gjigant duke u larguar nga zona e komoditetit tuaj dhe vendoseni veten para disa njerëzve të panjohur. Do të kuptoni se ky veprim do të frymëzojë si mendjen tuaj ashtu edhe trupin.

**PESHORJA**  
Kjo është një kohë e hapjes më të madhe në jetën tuaj - si nga ana emocionale ashtu edhe praktike. Bëhuni gati të keni shumë kohë të lirë në orarin tuaj për argëtim dhe miqësi. Sot, planifikoni disa ide për aktivitete në grup.

**AKREPI**  
Ju keni një zëkat të veçantë që ashtu siç është, mund t'ju pengojë të ecni përpara. Edhe nëse nuk duket e mundur të jetoni jetën tuaj pa atë, duhet të paktën ta provoni që të hiqni dorë.

**SHIGJETARI**  
Vetëm kur mendoni se një marrëdhënie kishte përfunduar, sot ajo do të marrë një njëjtë të madhe me energji të re! Përgatituni për një fillim të ri - plot me entuziazëm. Ky është shansi juaj për të bërë gjërat me shumë sukses.

**BRICJAPI**  
Ju jeni shumë të mençur dhe dera juaj është si një ndalesë e mundshme për gjatë rrugës për njerëzit që kërkojnë përgjigje. Megjithatë, sa i përket dashurisë toni i ditës tuaj nuk do të mbushet me shpresë.

**UJORI**  
Nëse dëshoni se diçka e mrekullueshme po gatuhet me disa nga njerëzit rreth jush, ndoshta keni të drejtë. Surpriza të këndshme duken në sfond. Sa i përket financave, tregoni më shumë vëmendje.

**PESHQIT**  
Ju nuk keni nevojë të keni një moment dramatik për të bërë disa ndryshime të nevojshme në jetën tuaj. Sot, një kthesë e madhe do të vijë në formën e një shkëmbimi të vogël mes jush dhe një mikut të vjetër. Përgjigje ose reagimi juaj do të tregojë se sa jeni i mirë.

**BLUE TOOTH**  
THASHETHEME MADE IN ALBANIA  
te rejat nga jeta ipave  
për të marrë 14135 me

**TRAJNERI I TIRANËS**

Fitorja me Flamurtarin në javën e fundit të fazës së dytë i dha kënaqësinë Tiranës që t'i vijojë më e qetë pushimet e dimrit dhe përgatitjet për pjesën e mbetur të sezonit. Trajneri Ardian Mema është i bindur se bardheblutë i presin ditë më të lumtura, por duhet shumë punë për ta çuar në vendin ku i takon. "Ka qenë një periudhë e vështirë nga mo-



menti që e kam marrë ekipin. Kemi ka patur oshilacione si ekip. Fillimi ka qenë shumë i vështirë, sepse kërkohej kohë që të përshtatesha me

lojtarët. Kemi zhvilluar disa ndeshje të mira, por që nuk na dhanë rezultatet pozitive. Këtë vit besoj se do të ndryshojë disa, sepse lojtarët e kanë kuptuar se çfarë duhet të bëjnë. Tirana ka qenë gjithmonë pjesë e elitës dhe nuk duhet të mbesë e tillë vetëm në letër," deklaroi Mema për "Supersport". Mema nuk ka ndryshuar qëndrim nga deklarata e pak javëve më parë. Tirana, sipas tij,

**Mema: Shpresoj që viti 2019 të më dhurojë buzëqeshje**

nuk mund të gabojë në merkato me zgjedhje emergjente por që mund të rezultojnë një dëshitim. "Nuk ka rezultuar ndonjë lojtar i lirë dhe i mirë që mund të vijë te Tirana. E kam thënë edhe më parë që emergjenca nuk të bën mirë. Nuk mund të bësh zgjedhje

emergjente, sepse gabon. Shpresoj të kemi fat dhe të dalë ndonjë lojtar që do të mund të na shërbejë." Lotët që i rrodhën në një intervistë para se të mbyllej viti 2018 e kanë një arsye. Si një njeri i familjes bardheblu, edhe emocionet që të shkak-

ton klubi më i titulluar në Shqipëri janë të mëdha. "Shpresoj të qesh, sepse ekipi realisht është në rrugë të mbarë. Tirana të shkakton emocione, unë kam qenë që fëmijë te Tirana dhe m'u kujtuan shumë gjëra dhe u përloja. Kam patur marrëdhënie të shkëlqyera me të gjithë krerët e klubit dhe i falënderoj, sepse më kanë ndihmuar shumë. Bashkërisht shpresoj ta shohim Tiranën sa më lart."

Menaxheri i kuq, Ildi Dajlani, konfirmon: Përforcimet e reja priten së shpejti



Jeton Selimi

**Gega pret përforcimet, Kuame firmos pas dy ditësh**

*Renato Arapi, shumë pranë rikthimit si i kuq*

Një qendërmbrojtës, një mbrojtës krahu dhe një sulmues. Këto janë 3 dëshirat e trajnerit Skënder Gega, që shpreson t'i plotësohen brenda fazës përgatitore nga ana e drejtuesve të Partizanit. Drejtuesit e kuq kanë disa emra në listë. Për qendrën e mbrojtjes synohet një lojtar shtatlartë dhe që përdor këmbën e majtë, ndryshe nga Belica dhe Atanda, që luajnë të dy me të djathtën. Idan Stein dukej se ishte fare pranë firmës me të kuqtë e kryeqytetit, por kërkesa e drejtuesve që izraeliti fillimisht të kalojë në provë nuk është pranuar nga agjentët e lojtarit, ndaj tani po kërkohej lista të reja, teksa pranë rikthimit me fanellën e kuqe duket se është Renato Arapi. Në krahun e djathtë të mbrojtjes synohet Ruben Ligeon, ish-lojtar i Ajaksit të Amsterdemit që së fundmi është aktivizuar me Zvollen në Holandë. Në sulm vijohet puna për të veshur të kuq sulmuesin Kuame Karikari të Neftçiti, me ganezin që duhet se ka pranuar ofertën prej 8



mijë eurosh në muaj të drejtuesve të Partizanit. Nëse kryeqytetasit do të arrijnë të kompletjnë këta tre reparte, atëherë dhe Gega do të ketë në dispozicion më shumë alternati-

va, pasi në pjesën e parë të sezonit loja është përëndruar kryesisht në një grup prej 13 lojtarësh. Kujtojmë që më herët Partizani ka afruar dhe dy mesfushorët Jusufi e Hyseni.

**KUAME PRANË** Ditët e fundit, po qarkullojnë zërat për një transferim të mundshëm të sulmuesit Kuame Karikari në kampionatin shqiptar dhe është Partiza-

ni, klubi që interesohet për shërbimet e tij. Sulmuesi ganez që aktivizohet me Neftçi Bakun në kampionatin azer, është prioritet i të kuqve këtë merkato janari. Interesimin e Partizanit, e ka pranuar edhe vetë menaxheri i skuadrës së Partizanit, Ildi Dajlani që në një prononcim për "AzeriSport.com" shprehet se kanë pasur kontaktet për futbollistët, të cilët janë në listën e të preferuarve dhe sa i përket Karikarit, ende nuk mund të thuhet asgjë. "Ne po punojmë për të tërhequr afrime të reja dhe kemi nisur të kontaktojmë për futbollistët, të cilët janë në listën tonë. Për Karikarin nuk mund të them ende asgjë, duke qenë se nuk e dimë si përfundon ky operacion. Pas disa ditësh, do të qartësojmë edhe afrimet e reja në skuadër", u shpreh Dajlani.

**TRAJNERI I TEUTËS**

Shkëmbi jep kushtrimin: Vendi i parë është vetëm 4 pikë larg

Teuta ka rifilluar punën për pjesën e dytë të sezonit me bindjen se mund të vazhdojë të qëndrojë pranë skuadrave të kreut dhe të ketë pretendime për të arritur objektiva madhorë. "Jemi gati ta rifillojmë ku e mbyllem, për fat të mirë lojtarët janë mirë fizikisht dhe shpresojmë që deri sa të fillojë kampionati ta mbyllim në nivele ku e lamë", tha Shëmbi për RTSH ku shpjegoi se merkatoja e klubit durrsak në janar ka qëllim vetëm përmirësimin e kontingjentin aktual. "Patjetër që mund të na afrohet ndonjë lojtar, duhet të jenë të mirë, cilësisht ndoshta më të mire se këta që kemi, që të na ndihmojnë. Në të kundërt jemi mirë me lojtarët që kemi".

Ndërkohë, Shkëmbi nuk fsheh se objektivi është Europa, por durrsakët hedhin një sy edhe nga lufta për titull. "Objektivat janë të qarta që në fillim, pjesëmarrja në Kupat e Europës. Patjetër të gjithë e mendojnë Teutën si pjesë të luftës për titull, ndoshta edhe ne, duke qenë 4 pikë larg vendit të parë. Normalisht që mund të bëjmë më shumë, por çdo gjë do ta marrim ndeshje pas ndeshje, deri aty ku mund të arrijmë. Skuadra po bën mirë nga java në javë, por në asnjë moment nuk mund të themi se jemi në maksimum se duhet të përmirësohemi, të bëjmë mirë në stërvitje dhe ndeshjet që vijjnë. Me punë çdo ditë, javë pas javë e ndeshje pas ndeshje mund të përmirësohemi më shumë", tha Shkëmbi.

**TRAJNERI I KASTRIOTIT**

Devulli: Dua 4-5 afrime cilësore në ekip

Bledar Devulli ka nisur djedje punën në Krujë dhe trajneri e ka të vështirë pasi skuadra ka pasur shumë largime. "Do të bëjmë 4-5 epike që të ndërtojmë një ekip konkurrues. Me punën e mirë që do të bëjmë, besoj se do të dalim nga kjo situatë. Shpresoj shumë që të realizojmë mbylljen me 90% të skuadrës". Ndërkohë, Devulli e stafi i tij kanë nisur menjëherë nga puna, ndërsa bëhet e ditur se në Krujë




tashmë po mendohet shumë edhe çështja e portës. Elson Demi duket gjithnjë e më afër. Ndërsa, në radhët e skuadrës krutane janë duke menduar edhe për të afruar ish-portierin e Bylisit të sezonit të shkuar, serbin Stefan Xhorxheviç. Ky i fundit ishte titullar në Ballsh gjatë sezonit të shkuar aty ku edhe spikati me formën e tij, ndërsa së fundmi ka luajtur në Gjermani, në ligat e ulëta.

**19-vjeçari i Lokomotivës**

Laçi vijon me të rinjtë, afron Enis Çokajn

Laçi vazhdon me strategjinë duke u fokusuar te të rinjtë. Trajneri Besnik Prenga, ka siguruar transferimin në formë huazimi nga Lokomotiva e Zagrebit, talentin e ri, Enis Çokaj. Ishte vetë Prenga që bëri të mundur kalimin e 19-vjeçarit në Kroaci, ndërsa tani e ka marrë tek Laçi si një përforcim për gjysmën e dytë të sezonit, por edhe për një mundësi për mesfushorin. Çokaj ka qenë tek ekipet e moshave të Shkëndijës së Tiranës, ndërsa ka qenë pjesë edhe e Vilaznisë U-15. I riu koplillas luan në qendër të mesfushës dhe bëhet lojtar i dytë që kurbinasit e marrin nga skuadra kroate. Në verë ishte Jon Mersinaj, i cili iu bashkua bardhezinjve dhe po luan rregullisht.





Mesfushori duket se e ka ndarë mendjen

Kosovar Sadiki zgjedh të luajë për Shqipërinë

Rivaliteti mes Shqipërisë dhe Kosovës vijon edhe në heshtje. Përzgjedhja e elementeve për skuadrat kombëtare të të gjitha moshave, përball shpesh stafet teknike apo edhe skautit me elementë të caktuar, për të cilët ka in-

teres edhe Kombëtarja kuqezi, edhe ajo e "dardanëve". Mirëpo, janë vetë futbollistët që shpesh bëjnë zgjedhjet e tyre, duke refuzuar njërin dhe pranuar tjetrën. I tillë është edhe rasti i Kosovar Sadikit. "Panorama Sport" ka mësuar

se mbrojtësi shtatllartë pritet që të bashkohet me Shpresat U-21 të drejtuara nga Alban Bushi, ndërkohë që për të ka pasur interes edhe Kosova, por shqetëson fakti se aktualisht është pa skuadër. Nga burime pranë FSHF-së mësohet se

qendërmbrojtësi i gjatë 1.95 centimetra ka pranuar interesimin e kugezinjve, duke refuzuar ftesën nga Kosova. Sadiki është i lindur në Gjermani, mirëpo mban nënshpirtësinë kosovare po ashtu edhe atë kanadeze. 21-vjeçari ka qenë pjesë e skuadrës U-19 të Stokes, si dhe i është bashkuar edhe Lokomotivës së Zagrebit në të shkuarën, ndërkohë që me përfaqësueset ka marrë pjesë në Lojërat Olimpikë me skuadrën e Kanadasë.

Në shkresën e nisur sekretarit Shulku sqarohet bllokimi i financave për gjirokastritë

KOLUMBIANI I BAJERNIT



Hames drejt Premier Ligës për 70 milionë euro

Kolumbiani Hames Rodriguez do ta lërë Bayernin, kjo është e sigurt. Ajo që mbetet për tu zbuluar është se ku do të shkojë fantazisti, i cili periudhën e fundit nuk ka pasur hapësirë e duhur të bavarëzët. Sipas asaj që raporton "Daily Mirror", Arsenali është gati të ofrojë 70 milionë euro për Hames Rodriguez, futbollistin që është në pronësi të Real Madridit. Për momentin ky është detaji i vetëm, ndërkohë që lojtari vetë ende nuk është shprehur se ku dëshiron ta vazhdojë karrierën. Dëshira e tij parësore është që të luajë rregullisht dhe tek Arsenali i ka shanset, duke parë që Mesut Ozil nuk është se preferohet nga trajneri Unai Emery.



Jeton Selimi

UEFA nis hetimin zyrtar ndaj Luftëtarit

I "mbyll gojën" Federatës Shqiptare të Futbollit



A shtu siç ishte paralajmëruar prej shumë muajsh, UEFA ka filluar një hetim zyrtar për trukime ndeshjesh kundër klubit të Luftëtarit. Skuadra gjirokastrite mori pjesë në Ligën e Europës për herë të parë në historinë e vet në këtë edicion por u njoftos me dy paraqitje të shëmtuara të cilat të kombinuar me luhajtjet e frikshëm të koeficienteve bënë që në të gjithë botën të ndizeshin sinjalet e dyshimeve për manipulime të rezultativitetit në favor të basteve sportive. UEFA ka nisur hetimin prej disa muajsh por është detyruar së fundmi të lajmërojë edhe FSHF-në se i ka bllokuar pagesën klubit gjirokastrit si pjesë e këtij hetimi. Sistemi BFDS (sistemi kompjuterik i UEFA-s që shërben për zbulimin e manipulimit të ndeshjeve) sinjalizoi luhajtjet e çuditshme dhe për këtë motiv ka nisur edhe ky proces, që në fakt ndodh rëndom në rast se ka dyshime. Deri në një vendim të dytë, edhe fondi i UEFA-s prej 240 mijë eurosh është "ngrirë" dhe kjo ka sjellë edhe një lloj problematike financiare në klubin gjirokastrit. Mosmarrja e fondit i ka nxjerrë drejtuesit jashtë

planeve të përllogaritura më herët. Ditën e djeshme, "Procesi Sportiv" ka publikuar shpresën tronditëse që UEFA i dërgon FSHF-së, për ta njoftuar se Luftëtarit është nën

hetim pikërisht për ndeshjen ndaj Ventspils

DOKUMENTI

"Kjo korrespondencë është për t'ju dhënë informacion në lidhje me shpërndarjen e pag-

esave të solidaritetit për klubet pjesëmarrëse në fazën kualifikuese të Ligës së Europës për sezonin 2018-2019. KS Luftëtarit është i përfshirë në disa ndeshje të Ligës së

Europës të cilat janë në hetim paraprak nga Komisioni i Integritetit i UEFA sipas nenit 12 të Rregullores Disiplinore të UEFA-s. Vini re që pagesat e solidaritetit janë bllokuar në pritje të përfundimit të hetimit. Siç jeni në dijeni, UEFA ka një detyrim të mbrojtë integritetin e kompeticioneve të saj dhe të parandalojë të gjitha mënyrat që mund të rrezikojnë rregullsinë e ndeshjeve apo aktiviteteve apo të lindin dyshime për abuzim me futbollin në përputhje me Nenin 2 të Statutit të UEFA. Si rrjedhojë, ne do të kërkonim që FSHF dhe klubi në fjalë të mos bëjë asnjë komunikim publik në lidhje me këtë komunikim dhe përmbajtjen e tij. Ju do të kontaktoheni nga Komisioni i Integritetit i UEFA në momentin e duhur nëse ndonjë gjë tjetër do të kërkohet nga ju në lidhje me këtë çështje".

Ish-kapiteni drejt Spanjës

Interi nis spastrimet, Ranokia i pari që largohet

Pak ditë më parë, në Itali u hap zyrtarisht merkatoja e janarit duke iu dhënë mundësi skuadrave që të afrojnë lojtarë, të cilët mund të ndihmojnë në pjesë e mbetur të sezonit, por kanë mundësi edhe të largojnë ata të cilët, duket se marrin rrogën kot. Kështu, tek Interi kanë nisur të mendojnë për spastrime dhe ai që pritet të largohet në vijim, është ish-kapiteni Andrea Ranokia. Mbrojtësi italian që për shumë vite ka luajtur me fanellën e Interit, por tashmë ka humbur vendin në formacion dhe duket se nuk është më në planet e Spaletit. Interes për Ranokian ka nga Spanja dhe është Vjareali skuadra, e cila interesohet për shërbimet e mbrojtësit italian. Spanjollët po pretendojnë që të forcojnë skuadrën në janar për arrijtjen e objektivave duke qenë se janë larg pritshmëri. Për mbrojtësin 30-vjeçar ka interes edhe nga klube të tjera, por mesa duket Vjareali është më pranë mesfushorit.



Vellsiani u largua në minutën e 78-të

Edhe Gareth Bejl braktis Realin e Madridin

Real Madridi po kalon një nga momentet më të errëta të viteve të fundit, duke qenë se përveç faktit që ndodhet larg titullit kampion, rezultatet e fundit dhe harmonia në skuadër është në nivelet e një skuadre që lufton për mesin e tabelës. Humbja e fundit në shtëpi me rezultatin 0-2 ndaj Real Sociedadit, ka nxjerrë në pah një tjetër pjesë delikate të Real Madridit. Sulmuesi uellsian Gareth Bejl ka qenë ai i cili ka braktisur skuadrën duke u larguar nga stadiumi rreth minutës së 78-të, atëherë kur rezultati ishte ende 1-0. I lënë jashtë nga trajneri Solari për shkak të një dëmtimi, Bejl është larguar edhe nga tribuna ku ishte akomoduar duke parë ndeshjen. Rezultati negativ, e ka bërë Bejlin që të largohet duke ngjallur jo pak debat në Madrid, duke qenë se në momente të tilla futbollistët pretendohet të jenë më të bashkuar, për ta kaluar të gjithë atë moment. Tifozët kanë qenë ata të cilët kanë reaguar më keq ndaj këtij veprimi të Bejlit.



Mbrojtësi kuqezi ka admirues

Napoli-Hysaj, krisja pritet të sheshohet ose...

Javët e fundit te Napoli ka lindur çështja "Hysaj". Për mbrojtësin shqiptar, siç bën me dije "Il Mattino", ka një pikëpyetje të madhe. Pas shpërthimit të agjentit të lojtarit, Mario Xhufredit, drejtuesit e Napolit po vlerësojnë situatën. Në klubin napoletan duan të dinë qartësisht se çfarë do të ndodhë me Hysajin, por kuptohet që nëse ka një krisje, duhet që të sistemohet gjithçka sa më shpejt, duke nisur nga kur ekipi do të grumbullohet për të nisur përgatitjet. Pak ditë më parë, agjentit i Hysajit, Xhufredit, deklaroi se mbrojtësi është kthyer tashmë në një zgjedhje të katërt për trajnerin Anceloti dhe se Napoli duhet ta shesë. Çelsi në Angli dhe Atletico Madrid në Spanjë janë dy skuadrat e përmendura si destinacione të mundshme të futbollistit shqiptar, por deri në këtë moment mbeten vetëm hipoteza. Ajo që kuptohet qartë ka të bëjë me faktin se marrëdhëniet Napoli-Hysaj janë ftohur shumë kohë e fundit.



Sulmi i 29 dhjetorit, azilkerkuesit largohen nese shkelin ligjin

Marrë nga Deutsche Welle

# Ministri i Punëve të Brendshme: Kush dëbohet nga Gjermania dhe kur

## "Kërcënimi" i azilkerkuesve të dënuar, ndryshon ligji gjerman

Horst Seehofer, ministri i Punëve të Brendshme të Gjermanisë, synon dëbime më të shpejta të atyre azilkerkuesve që kryejnë vepra penale. Por rregulloret se kur një azilkerkues duhet të dëbohet janë mjaft të detajuara. Sipas ministrit të Punëve të Brendshme të Gjermanisë, Horst Seehofer (CSU), azilkerkuesit duhet të dëbohen menjëherë, në rast se ata shkelin ligjin në Gjermani. Së shpejti, Seehofer do t'i paraqesë qeverisë gjermane propozime të reja për ndryshime të caktuara ligjore. Kërkesat e tij vijnë pas një sulmi të javës së kaluar në qytetin bavarez Amberg. Më 29 dhjetor, katër azilkerkues të alkoolizuar nga Siria, Afganistani, Irani të moshës 17-19 vjeç sulmuan kalimtarë në rrugë duke i qëlluar 12 vetë u lënduan. Aktualisht në Gjermani nuk ka të dhëna, se sa vetë dëbohen pas kryerjes së një veprë penale, në tërësi vitin e kaluar ka rënë numri i dëbimeve. Në gjysmën e parë të vitit 2018 u dëbuan 12.300 vetë, krahasuar me vitin 2017, një rënie me 2%. Edhe ligji gjerman si rregull i ndalon dëbimet, nëse personi që do të dëbohet, kërcënohet nga tortura apo vdekja në vendin e origjinës, ose nëse jeta e tij vihet në rrezik për shkak të feses, racës, nacionalitetit, bindjes politike apo përkatësisë në një grup social.

**Kush dëbohet nga Gjermania?**  
Të huajt që duan të jetojnë në Gjermani kanë nevojë për një leje qëndrimi, refugjatët dhe azilkerkuesit marrin vetëm një leje të përkohshme qëndrimi, për sa kohë, që trajtohet kërkesa e tyre. Në rast se kërkesa e azilit refuzohet, ata nuk



Ministri i Punëve të Brendshme të Gjermanisë, Horst Seehofer

kanë më të drejtë qëndrimi dhe duhet ta braktisin Gjermaninë brenda një afati të caktuar, (jo më larg se 6 muaj). Nëse ky afat skadon, atëherë ata dëbohen me detyrim nga Gjermania në vendin e origjinës. Më 29 dhjetor në Amberg, katër azilkerkues të alkoolizuar nga Siria, Afganistani, Irani të moshës 17-19 vjeç sulmuan kalimtarë në rrugë. **Çfarë ndodh me të huajt që kryejnë krime?**  
Një person, i cili gjatë kohës së trajtimit të kërkesës së azilit dënohet me burgim të paktën deri në tre vjet, duhet teorisht të dëbohet. Për personat e tjerë, që dëno-

hen për vepra penale të vogla, ose nëse ata shihen si kërcënim për rendin publik, vendosin autoritetet vendore për dëbimin e tyre. Vendimi i tyre bazohet në dy faktorë: Sa e rëndë ka qenë vepra penale e kryer dhe sa e lartë është nevoja për mbrojtjen e të dënuarit që duhet dënuar? Një person, që ka kryer vetëm shkelje ligjore, dhe që në vendlindje kërcënohet nga tortura apo vdekje, nuk dëbohet. Tek një i huaj me familje gjermane me një vend pune të caktuar, shansi për dëbim është po ashtu i vogël, nëse ai nuk ka kryer një krim të rëndë. Një rregullorë e

përgjithshme thotë, se të huajt që të paktën dënohen me dy vjet heqje lirie mund të dëbohen. Edhe një vit dënim përbën arsye dëbimi, nëse vepra penale e kryer është pjesë e një katalogu veprash penale, që u krijua pas sulmeve të Vitit të Ri 2015/2016 në Köln. Atëherë një grup migrantësh afrikanoveriorë apo arabë sulmuan apo ngacmuan seksualisht femrat. Ky katalog përmban vepra penale si lëndim trupor, krime seksuale apo rezistencë kundër autoriteteve përbaruese. **Kush vendos se kush dëbohet?**  
Dy autoritete e kanë ko-

mpetencën për dhënien e vendimit të dëbimit nga Gjermania - zyra e të huajve, që është pjesë e qeverive të lendeve federale dhe Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët, BAMF. Në shumicën e rasteve zyra e të huajve është përgjegjëse për dhënien e zbatimit e urdhërave të dëbimit, por në procesin e trajtimit të kërkesës së azilit, është BAMF, që ka po ashtu të drejtë, pas refuzimit të kërkesës, të kërkojë dëbimin. Edhe në raste të tilla, zbatimin e bën zyra e të huajve të landit federal, ku qëndron personi. Për shkak se ka shumë njerëz që nuk duan të largohen vullnetarisht, zyra e të huajve thërret si ndihmë policinë. Procesi i dëbimit është detyrë e kontrollit kufitar, dëbimet kryhen nga Policia Federale, që siguron kufijtë e vendit. Por autoritetet mund të bëjnë edhe kërkesë në gjykatë për "mbajtje në burg para dëbimit" që mund të zgjasë deri në 18 muaj. Kjo, në rast se ata kanë të dhëna se personi mund të fshihet.

**A kanë të drejtë të prekurit të apelojnë vendimin?**  
Po. Personat, të cilëve iu është refuzuar kërkesa e azilit, mund të ankojnë tek Gjykata Administrative, që verifikon vendimin e autoriteteve. Por atyre që iu është refuzuar kërkesa "dukshëm e pajustifikuar", kanë vetëm një javë kohë të apelojnë, të tjerët vetëm dy javë. Vitet e kaluar, punonjësit e mbingarkuar të BAMF duket se kanë marrë vendime të gabuara vitet e fundit. Shumë azilkerkues ankimojnë vendimet, e deri në vendimin e gjykatës mund të qëndrojnë në Gjermani.

**Cilat janë arsyet që sjellin shtyrjen e dëbimit?**  
Mes atyre që janë të detyruar të braktisin Gjermaninë, shumë nuk dëbohen, kur janë të sëmure fizikisht apo kanë probleme psikike, ose sepse u mungojnë dokumentet e identitetit, si pasaporta apo karta e identitetit. Por edhe personat që fillimisht lejohet të qëndrojnë, mund të dëbohen. Kjo ndodh në refugjatët e luftërave të Ballkanit në vitet 90-të. Refugjatët nga ish-Jugosllavia duhet të ktheheshin në shtëpi, pas stabilizimit të situatës në vendlindje.

### SHKURT

#### Sulmohet ambasada e SHBA në Athinë

Ditën e hënë ambasada e Shteteve të Bashkuara në Athinë është sulmuar nga pjesëtarë të grupimit anarkist "Rubikoni". Sulmi, që u shënu në orën 03 e 30 pas mesnate, u krye në hyrje të parkingut të ambasadës, që ruhet nga personeli i sigurisë së përfaqësishë diplomatike amerikane. Anarkistët hodhën drejt mureve dhe deryve shishe e tollumbace të mbushura me bojë të kuqe. Menjëherë forcat e policisë që ndodhen të dislokuara rreth ambasadës, filluan ndjekjen dhe tetë persona janë shoqëruar në polici si të dyshuar. Anarkistët publikuan paraditen e të hënës një komunikatë, ku shpjegojnë se sulmi u krye si reagim ndaj politikës së SHBA-ve në Siri, dhe në rajonin e Ballkanit. Kujtojmë që në vitet 1996 dhe 2007, godina e ambasadës ishte goditur me predha, ku pati vetëm dëme materiale.

#### Italia kërtime për naftë në Jon

Pas Greqisë edhe Italia ka autorizuar nisjen e kërkimeve për naftë në Detin Jon. Sipas Buletinit zyrtar të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në Itali kërkimet do të bëhen në një sipërfaqe prej 2200 km2 dhe do të shtrihen deri në pikën e kufirit detar mes Italisë dhe Shqipërisë. Sipas marrëveshjes për delimitimin detar të vitit 1992, leja për caktohet pa paragjykimin e palëve të treta. Megjithatë një marrëveshje për fundimtare mes tre vendeve kufitare Italisë, Shqipërisë dhe Greqisë ende nuk ekziston. Vendimi për të bërë kërkime për hidrokarbure në detin Jon ka ngjallur reagime dhe ka përplasar partitë brenda koalicionit. Ministri i Mjedisit Sergio Costa tha se nuk ka firmosur dhe nuk do të firmosë kurrë një urdhër për kërkime në det. Ambientalistët i kujtojnë lëvizjes 5 Yjet, premtimet elektorale kundra kërkimeve detare dhe kundër gazsjellësit TAP. Mirëpo lideri i 5 yjeve dhe zv/kryeministri Luigi Di Maio mbrohet duke thënë se këto kërkime janë autorizuar nga qeveria e kaluar e Paolo Gentilonit. Kërkime në jugperëndim të Korfuzit ka autorizuar edhe Greqia, e cila pritet që në muajin tetor të ligjërojë shpalljen e ujërave territoriale në 12 milje, siç pohoi para pak ditësh ministri i Jashtëm plotësisht i Greqisë Jorgos Katrugalos.

### Theresa May: Pa BREXIT, futemi në rrugë të panjohura

## Kryeministria britanike: Do zbatojmë tri masa si dhe do kërkojmë garanci ndaj BE-së

Kryeministria britanike paralajmëroi se Britania e Madhe rrezikon të futet në "rrugë të panjohura" nëse ligjënesit e saj nuk votojnë marrëveshjen e propozuar për daljen e vendit nga Bashkimi Europian. Ky paralajmërim u drejtohet kundërshtarëve të saj politikë të dielën, pak ditë përpara mbledhjes së parlamentit për të diskutuar marrëveshjen e Brexit. Në një intervistë për rrjetin publik anglez të lajmeve BBC, kryetarja e qeverisë premtoi një sërë masash që do të bindin më skeptikët të vo-




tojnë për marrëveshjen rreth javës së dytë të janarit. Qëndrimi i May ka ardhur vetëm pak ditë pas reagimit të krerëve më të lartë të BE, të cilët paralajmëruan realizimin e Brex-

**THERESA MAY**  
"Nëse nuk arrijmë që ta votojmë marrëveshjen për Brexit, rrezikojmë të hyjmë në një territor të panjohur. Prandaj në ditët në vijim do të ofrojmë disa garanci, disa masa. Masa e parë ka të bëjë me Irlandën e Veriut, masa e dytë me rolin e parlamentit në stadin e mëtejshëm të negociatave me aleatët tanë. Ndërsa masa e tretë lidhet me garancitë që do i kërkojmë Bashkimit Europian për të adresuar problemet që ne kemi ngritur," tha

it pavarësisht votimit në parlament. "Nëse nuk arrijmë që ta votojmë marrëveshjen për Brexit, rrezikojmë të hyjmë në një territor të panjohur. Prandaj në ditët në vijim do të ofrojmë disa garanci, disa masa. Masa e parë ka të bëjë me Irlandën e Veriut, masa e dytë me rolin e parlamentit në stadin e mëtejshëm të negociatave me aleatët tanë. Ndërsa masa e tretë, dhe për këtë jemi ende duke punuar, lidhet me garancitë që do i kërkojmë Bashkimit Europian për të adresuar problemet që ne kemi ngritur," tha May.

### Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
- Dillon aktor.
  - Një listë që zgjidhet nga regjisor
  - Sigla e tritolit.
  - Kapiteni që ndiqte balenën Moby Dick.
  - Eshhtë spektatori i yni.
  - Fillojnë tejen
  - Një sinjal akustik.
  - Një parashtesë për... përtej.
  - Eshhtë partia e Sali Berishës.
  - Kanë organizatën Hamas.
  - Gëlojnë nga murgjit.
  - Në teori kur mungon ti.
  - Inicialet e Gide.
  - Inicialet e Asimov.
  - Nisen pa ne.
  - Kreshniku i volejbolit.
  - Kufijtë e tokës.
  - Mund të jenë autonome të tilla.
  - Britma e Arkimedit.

- Fillojnë vetëm.
- Bota jashtë ëndrrës.
- Mund të jenë ushtarake.
- Italia në Internet.
- Gjysmë atomik.
- Janë prova inteligjence
- Një libër hartash.
- Clapton i muzikës.

**VERTIKAL**

- I famshëm ai i Trojës.
- Një... bombë tenistike.
- Fillojnë themelet.
- Mund të jetë klasifikimi.
- Një letër... kampioni.
- Eshhtë pozicioni për gjumë.
- Janë diktatorët despotikë.
- Një kryeqytet afrikan.
- Që mesfushor i famshëm i Ajax.
- Ekstreme në tenis.
- Eshhtë e dendur në xhungël.
- Eshhtë brrinjë në skuader.
- Eshhtë pako që dërgohet.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Bëjnë taktika me taka.
- Vetot pa kufij.
- Persekutonin romakët.
- Eshhtë gri ajo e turrit.
- Një mund të jetë spiunzhi.
- Janë vendet për nisje.
- Me to bëjnë torta.
- Janë katër në kitarë bas.
- Institucione Urbane Rajonale.
- Priten me lotë në sy.
- Një rreth pa ekstreme.
- Gjysmë kasate.
- Eshhtë cilësia.
- Ente Tregtare Lokale.
- Një pjesë e territorit.
- Në hyrje të oazit.


### Fjalëkryqi (2)

**HORIZONTAL**


- Jagger i Rolling Stones.
- Zanore për kuaj.
- Janë dhelpira.
- Janëlet e Lendl ish tenist.
- Kufizojnë rastet.
- Mbyllen me epilog.
- Eshhtë simbol ngadalësie, por jo breshkë.
- Gjysmë njeriu.
- Janë fruta ekzotikë.
- Një minierë e vjetër.
- Ata tanë ishin ilirë.
- Masat pa kufij.
- Një gëzim i madh.
- Agjenci Ndërmjetëse Përmet
- Eshhtë godinë në miniaturë
- Film i Ridley Scott
- Duken të gjata në pritje.
- Njëzetmije... në det në një libër të Jules Verne.

**VERTIKAL**


- Një legjendë.
- Përfundojnë një stil.
- Nuk e ulin kokën.
- Këndohen në opera.
- Janë tek në Somali
- Eshhtë lloj papagalli.
- Mbyllin komentin.
- Eshhtë e parë për prodhim.
- Kush ka do të pijë.
- Janë binarë.
- Rolet pa ret.
- Vihen për të mbyllur të tilla.
- Janë tek në mantel.
- Salgari që krijoi Sandokan.
- Një stinë e ngrohtë.
- Janë pamje nga puna.
- Një fjalë goxha.
- Ato Eiliams janë teniste
- Ishin të parët tanë.
- Janë edhe ato polare.
- Fillojnë nazet.
- Inicialet e Triolet.
- Një bëhet me pozë.
- Mbyllin punimet.
- Nodoh në kufij.
- Perignon i champagne-s.
- Eshhtë iks ajo e sulmit.
- Enti europian i hapësirës.
- Fillojnë lehtë.



### Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

### SUDOK

1	3		2			7	4
	2	5		1			
4	8		6				5
			7	8		2	1
5				9		3	7
9			3				5
	4				6	8	9
	5	3			1	4	
6							

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	3	6	1	7	8	2	5	9
5	7	8	2	9	6	1	4	3
9	2	1	3	4	5	6	7	8
6	9	3	4	8	1	7	2	5
7	1	2	5	6	9	3	8	4
8	4	5	7	2	3	9	1	6
1	8	9	6	5	7	4	3	2
2	6	7	8	3	4	5	9	1
3	5	4	9	1	2	8	6	7

### Argëtim filozofik

- Në demokraci secila parti i kushton pjesën më të madhe të energjisë së tij për të provuar se tjetri nuk është në gjendje për të qeverisur. Të dyja kanë sukses. Të dyja kanë të drejtë.
- Të gabosh është njerëzore. Për të hedhur fajin mbi të tjerët edhe më shumë.
- Shoferi i kujdesshëm është ai i cili kur kalon me të kuqe, i bie borisë.
- Nëse seksi është kaq i natyrshëm, atëherë pse ka kaq shumë libra me udhëzime se si ta bëni?

### KRIPTOSKEME

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

P	S	A	F	S	O		14	4		14	7	4	15
4	11	4		1	8	12	2	5	14	5			10
10		1		4	1	2	8	10	6	3	7	5	
4	7		1	7	5	8	9	4	2	10	4		
15	3	1		6	2	10	5	2	6				12
	7	1	11	13	5			1	5		17	15	1
17	3	10	13	3		4	4		4	10	6	3	
4		2	4	7		11		6	10	4	2	4	
12	1	5	16	4	10	5		4	4		8	16	
14	4	7	4		8	14	5		17	3	10	10	
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	5	4	
2	4	2	5		4	1	2	9	10	6		2	

C	R	A	L	K	I	M	I	S	T	I
C	O	S	T	N	E	R		P	A	V
I	L	R	M	I	I	K	L	A		
R	K	O	P	E	R	N	I	K	U	N
K	O	O	P	E	R	A	T	I	V	A
K	L	I	N	I	K	E		L	F	
T	R	O	K	E	I	R	O	N	I	K
R	S	A	L	T	E	V	I	T	A	
I	T	A	L	I	A	S	E	E	V	A
U	L	E		M	A	R	T	A	C	
M	A	E	J	E	A	N	L	I	J	A
F	U	T	U	R	I	S	T	E	T	A

- Nuk e ka fajin pasqyra ... në qoftë se hunda juaj është e shtrembër.
- Në të dyja martesat e mia kam qenë shumë i pafat. Me të parën u ndava, me të dytën jetova gjithë jetën.
- Realiteti është një iluzion që shkaktohet nga mungesa e alkoolit.

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

HESAPETETTPABC  
EMIRATEARABET  
LIKERBETONET  
ELSAADRIVALET  
NMRBURIMETJAJA  
MAROKENEODAT  
FULLANIEMEA  
PLAATOMICKEA  
ANSTEROOLT  
PARSDMARIJA  
ANNANIAPRESTION  
SARDOUDETETA

**FJALËKRYQI (1)**

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

PARAGRAFILIVAN  
IRONIAOSERA  
RABATABANARAJA  
AMEATANVRIMAJA  
TTITTELEMAKULLA  
SKPOLEMIKALEL  
VKANARINAENNA  
ALVATIKANILEN  
JOETNESTEMAJA  
RIMAREADETIA  
ARIANAAARUNIK  
TALARENTMAURICE

**FJALËKRYQI (2)**



### Thënie të mëçuara

- Më pëlqejnë vetëm dy lloje femrash: ato vendase dhe të huajat.
- Statistikat janë si minifundet. Ato tregojnë shumë, por fshehin thelbin.
- Statistikat thonë se një në katër njerëz vuajnë nga një çrregullim mendor. Mendoni për tre miqtë tuaj më të mirë. Nëse ata janë të shëndetshëm, atëherë ju keni një problem.

